

Libër mësuesi

Lediana Bardhi

Aftësim
Teknologjik

5



mediaprint

FAQJA KRYESORE

0100 1 9 12

RRETH NESH

profili i kompanisë

SHTËPIA BOTUESE

librat tani

SHTYPSHKRONJA

teknologjia më e fundit




www.mediaprint.al

KLKONI KËTU

Librat e mësuesit dhe planet mësimore
për të gjithë titujt që ne disponojmë,
mund t'i gjeni dhe t'i shkarkoni
pa pagesë nga faqja e internetit
www.mediaprint.al

Për më shumë informacion
mund të na shkruani në adresën e emailit:
botime@mediaprint.al

ose të na kontaktoni pranë redaksisë
në numrin e telefonit:
04 2256158



Lediana Bardhi

Libër mësuesi Aftësim teknologjik 5

*Teksti mësimor Aftësim teknologjik 5 është hartuar nga:
Lediana Bardhi, Gjergji Gjino*

SHTËPIA BOTUESE
mediaprint

Titulli: **Libër mësuesi Aftësim teknologjik 5**

Autor: **Lediana Bardhi, Gjergji Gjino**

Drejtoi botimin: **Anila Bisha**

Redaktore gjuhësore: **Sofika Konomi**


Kopertina: **Visidesign**

Design: **Mirela Ndrita**

Shtypi: **Mediaprint**

ISBN: 978-99956-93-72-5

Botimi i parë, 2011

© Të gjitha të drejtat janë të rezervuara 

Të gjitha të drejtat e autorit lidhur me këtë botim janë ekskluzivisht të zotëruara/rezervuara nga Shtëpia Botuese "Mediaprint" sh.p.k..

Ndalohet çdo prodhim, riprodhim, shitje, rishitje, shpërndarje, kopjim, fotokopjim, përkthim, përshtatje, huapërdorje, shfrytëzim dhe/ose çdo formë tjetër qarkullimi tregtar, si dhe çdo veprim cënues me çfarëdo lloj mjete apo apo forme, pjesërisht dhe/ose tërësisht, pa miratimin paraprak me shkrim nga Shtëpia Botuese "Mediaprint" sh.p.k.

Ky botim, në tërësi dhe/ose në pjesë të tij, ndalohet të transmetohet dhe/ose përhapet në çdo lloj forme dhe/ose mjet elektronik, mekanik, regjistruar dhe/ose tjetër, të ruhet, depozitohet ose përdoret në sisteme ku mund të çënohen të drejtat e autorit, pa miratimin paraprak me shkrim nga Shtëpia Botuese "Mediaprint" sh.p.k..

Çdo cënim i të drejtave të autorit passjell përgjegjësi sipas legjislacionit në fuqi.

Kontaktet:

www.mediaprint.al

Shtëpia Botuese
Kutia Postare 7467 - Tiranë
Tel.: 04 2258 156
Cel.: 069 40 44 443
botime@mediaprint.al

Spektori i Shpërndarjes dhe Marketingut:
Tel.: 04 4500605
Cel.: 069 40 44 441
Cel.: 069 40 20 201
distributor@mediaprint.al

Shtypshkronja:
Tel.: 04 4500605
Cel.: 069 40 50 380
Cel.: 069 20 79 021
print@mediaprint.al

Komente dhe sugjerime janë të mirëpritura në email: botime@mediaprint.al

PËRMBAJTJA

| | |
|---|-----------|
| Hyrje | 6 |
| Kapitulli I: Teknologjia e materialeve dhe proceseve | 9 |
| Mësimi 1 OBJEKTET RRETH NESH – Teori | 9 |
| Mësimi 2 OBJEKTET PREJ DRURI – Teori | 10 |
| Mësimi 3 PËRDORIMI I DRURIT – Teori | 12 |
| Mësimi 4 METALET DHE PËRDORIMI I TYRE – Teori | 14 |
| Mësimi 5 VESHJET DHE MATERIALET E TYRE – Teori | 13 |
| Mësimi 6 PUNË PRAKTIKE | 17 |
| Mësimi 7 PUNË PRAKTIKE | 18 |
| Mësimi 8 USHTRIME | 19 |
| Kapitulli II: Objektet dhe paraqitja e tyre grafike..... | 20 |
| Mësimi 1 OBJEKTET DHE FIGURAT GJEOMETRIKE – Teori | 20 |
| Mësimi 2 MJETET MATËSE DHE SKICIMI I TYRE – Teori | 22 |
| Mësimi 3 PUNË PRAKTIKE | 23 |
| Mësimi 4 USHTRIME | 24 |
| Kapitulli III: Teknologjia e informacionit dhe komunikimit | 25 |
| Mësimi 1 OBJEKTET E KOMUNIKIMIT – Teori | 25 |
| Mësimi 2 KOMPJUTERI DHE TELEVIZORI – Teori | 27 |
| Mësimi 3 MJETET E THJESHTA TË KOMUNIKIMIT – Teori | 29 |
| Mësimi 4 USHTRIME | 30 |
| Kapitulli IV: Strukturat, forcat dhe mekanizmat | 31 |
| Mësimi 1 FORCAT DHE MAKINAT E THJESHTA – Teori | 31 |
| Mësimi 2 STRUKTURAT – Teori | 33 |
| Mësimi 3 PUNË PRAKTIKE | 34 |
| Mësimi 4 USHTRIME | 36 |
| Kapitulli V: Njeriu dhe shoqëria në teknologji | 37 |
| Mësimi 1 NJERIU DHE TEKNOLOGJIA – Teori | 37 |
| Mësimi 2 TEKNOLOGJIA DHE MJEDISI – Teori | 39 |
| Mësimi 3 UJI DHE DOBIA E TIJ – Teori | 40 |
| Mësimi 4 SAPUNI – Teori | 42 |
| Mësimi 5 FURÇAT DHE PASTA E DHËMBËVE – Teori | 43 |
| Mësimi 6 PUNË PRAKTIKE | 44 |
| Mësimi 7 BUKA DHE PRODHIMI I SAJ - Teori | 46 |
| Mësimi 8 QUMËSHTI DHE NËNPRODUKTET E TIJ - Teori | 47 |
| Mësimi 9 PUNË PRAKTIKE | 49 |
| Mësimi 10 USHTRIME | 50 |

HYRJE

Libri “Aftësimi teknologjik 5” është tekst shkollor për nxënësit e klasave të pesta të shkollave nëntëvjeçare, miratuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

Objektivat:

- Të përfshijmë nxënësit në nxjerrjen e përfundimeve nga aktivitetet, eksperimentet dhe detyrat praktike.
- Të testojmë dhe riprodhojmë njohuritë e tyre nëpërmjet pyetjeve dhe diskutimeve në fund të çdo aktiviteti apo eksperimenti të mësimit.
- Të nxisim nxënësit për të folur rreth dukurive që prek mësimi përkatës.
- Të gërshetojmë kontrolle individuale, kontrolle kolektive si dhe punë në grup apo dyshe – dyshe për të arritur një rezultat më të mirë në kontrollin e nxënësve.
- Të stimulojmë punën kërkimore të vetë nxënësve nëpër detyrat praktike.
- Të nxisim nxënësit për të parë botën që i rrethon me syrin e shkencës dhe të teknologjisë.
- Të nxisim nxënësit për të shkruar në mënyrë konkrete, për të përmbledhur dhe për të argumentuar.
- Të ushtrojmë nxënësit me përdorimin në të folur me fjalorin shkencor dhe teknologjik. Në këtë pikë mësuesi duhet të jetë i kujdesshëm ndaj fjalorit të përdorur gjatë zhvillimit të orës së mësimit.
- Të praktikojmë tek nxënësit komunikimin dhe të kuptuarit e njëri - tjetrit, si dhe t’i mësojmë që të respektojnë mendimet dhe argumentet e shokut.

Parimet:

- Të përdoren strategji të tilla si shpjegimi i një pjese të mësimit, nisur nga një situatë problemore apo pyetjeje kyç.
- Të nxitet tek nxënësit të menduarit kritik me pyetje të hedhura nga mësuesi si: çfarë? si? dhe pse.
- Të evitohen situatat monotone gjatë orëve të mësimit.
- Të inkurajohen nxënësit që të përfshijnë sa më shumë nga përvoja e tyre personale gjatë orëve të mësimit. Mos harroni që nga një përvojë e thjeshtë, mund të lindin situata problemore.
- Të përdoren edhe njohuritë e mësuara në lëndët e tjera. Kjo shërben si përsëritje, por edhe si vetëvlerësim që nxënësi i bën vetes për njohuritë e marra në vite.
- Të ndërgjegjësohen nxënësit për progresin e njohurive gjatë vitit shkollor.
- Të nxitet entuziazmi i nxënësve gjatë një eksperimenti apo një projekti. Kjo mund të realizohet duke vënë drejtues vetë nxënësit në projekte të caktuara.

Materialet:

Libri i nxënësit

- Ky libër trajton pesë çështje kryesore: **1. Teknologjia e materialeve dhe proceseve;** **2. Objektet dhe paraqitja e tyre grafike;** **3. Teknologjia e informacionit dhe e komunikimit;** **4. Strukturat, forca dhe mekanizmat;** **5. Njeriu dhe shoqëria në teknologji.**
- Mësimi ndahet në dy grupe: **1. teoria, njohuritë e reja në fillim të tij.** **2. aktivitetet në mbështetje të teorisë, të cilat janë 2 ose 3 për çdo mësim.** Nxënësit nxiten që të marrin pjesë aktive në mësim nëpërmjet përfundimeve të eksperimenteve apo detyrave praktike.
- Çdo mësim dhe eksperiment është i shoqëruar me ilustrime, si dhe me hapësira boshe ku nxënësi mund të shkruajë në mënyrë të përmblodhur përfundimet.
- Orët - Punë praktike vendosen çdo 3 apo 4 orë, gjë që përforcon njohuritë e marra në mësimin paraardhës si dhe mësohen edhe elemente të reja.
- Gjithashtu libri përmban edhe 1 orë ushtrime në fund të çdo kapitulli, teste ku nxënësi kontrollon rreth njohurive të marra.

Udhëzuesi pedagogjik

- I lehtë në përdorim, udhëzuesi është një material shumë i rëndësishëm për orën e mësimt. Çdo mësim është i shoqëruar me shënime të shumta dhe propozime të ndryshme:
 - Fillimisht një përmblodhje e detyrave që duhen zbatuar gjatë mësimt, ndiqet nga materiali që do të nevojitet për këtë orë mësimi, objektivat dhe fjalori.
 - Më pas realizohen një sërë veprimtarish, disa prej të cilave mund të jenë edhe fakultative. Veprimtaria e parë do të jetë ajo e përsëritjes, mbështetur në aparatën pedagogjike. Gjithashtu përshkruhen përgjigjet e ushtrimeve apo pyetjeve që figurojnë në librin e nxënësit.
 - Informacione dhe kuriozitete mund të plotësojnë informacionin mbi temën dhënë nga mësuesi.

Struktura e librit të nxënësit

Libri i nxënësit përmban 5 kapituj. Një temë është parashikuar të zgjasë 45 minuta, kohëzgjatja normale e një ore mësimi; kështu libri është konceptuar të zgjasë për 35 orë aftësimi teknologjik.

| | |
|-----------------|---------------|
| Programi | 35 orë |
| Teori | 18 |
| Punë praktike | 7 |
| Ushtrime | 5 |
| Orë të lira | 5 |

Teoritë janë lehtësisht të dallueshme nga punët praktike pasi shënohen tek tema tek libri i nxënësit:

Kapitulli I: Teknologjia e materialeve dhe proceseve

5 orë Teori + 2 orë Punë Praktike + 1 orë Ushtrime

Kapitulli II: Objektet dhe paraqitja e tyre grafike

2 orë Teori + 1 orë Punë Praktike + 1 orë Ushtrime

Kapitulli III: Teknologjia e informacionit dhe komunikimit

2 orë Teori + 1 orë Punë Praktike + 1 orë Ushtrime

Kapitulli IV: Strukturat, forcat dhe mekanizmat

2 orë Teori + 1 orë Punë Praktike + 1 orë Ushtrime

Kapitulli V: Njeriu dhe shoqëria në teknologji

7 orë Teori + 2 orë Punë Praktike + 1 orë Ushtrime

Tek udhëzuesi pedagogjik jepen edhe propozime për orët e lira.

Aktivitetet

Ushtrimet me gojë:

- Ushtrimet e riprodhimit klasik dhe të përgjigjeve tek pyetjet e aktiviteteve.
- Diskutimet e ndryshme, pjesë përbërëse e librit të nxënësit.
- Shtimi i shembujve të librit nga nxënësit, bazuar në përvojën e tyre të përditshme.
- Detyrat praktike në grupe.

Ushtrime me shkrim:

- Plotësimi i eksperimenteve.
- Plotësimi i tabelave.
- Plotësimi i detyrave praktike.
- Ushtrimet në fund të çdo kapitulli.

Kapitulli I: Teknologjia e materialeve dhe proceseve

Mësimi 1 OBJEKTET RRETH NESH – Teori

Detyra për t'u realizuar:

- Të lexohet me kujdes mësimi mbi objektet dhe materialet përbërëse të tyre.
- T'i jepet përgjigje pyetjeve dhe diskutimeve tek aktivitetet e mësimit të ditës.

Materialet: libri i nxënësit, faqe 6 – 7.

Objektiva për t'u realizuar:

- Të dallojnë materialet përbërëse të objekteve që na rrethojnë.
- Të përshkruajnë objektet, duke u mbështetur tek materialet dhe përdorimi i tyre.
- Të njihen me disa nga lëndët e para të materialeve dhe proceset e përpunimit të tyre.
- Të praktikojnë përdorimin e objekteve në veprimtari konkrete.

Fjalor: lëndë e parë, proces përpunimi.

Prezantimi i lëndës

Kjo lëndë u shërben nxënësve për të fituar një koncept të ri për teknologjinë. Çdo objekt që ata përdorin në jetën e përditshme është një shpikje teknologjike. Ky libër përqendrohet tek disa nga këto objekte, materialet e tyre, skicimin, etj. Gjithashtu, nxënësit do të fitojnë edhe njohuri mbi gjërat që i ndihmojnë ata të ushqehen dhe pastrohen. Efekti i teknologjisë mbi mjedisin dhe shëndetin tonë trajtohet jo vetëm në një orë mësimi, por ai preket si çështje edhe gjatë orëve të tjera.

Veprimtari në klasë për kuptimin e mësimit dhe të riprodhimit

Përshkrimi i objekteve

Kërkojini nxënësve të numërojnë sa objekte përdorin ata çdo ditë. Rezultati i numërimit është koha e madhe që nxënësit do harxhojnë duke i përmendur të gjitha objektet. Ato janë të shumta. Ne i përdorim objektet për qëllime të caktuara dhe në bazë të funksionit që kanë, zgjidhen materialet përbërëse të tyre. Jepni disa shembuj dhe nxitni nxënësit të japin shembujt e tyre.

Nga se përbëhen objektet?

Merrni një laps dhe një fletore. U kërkoni nxënësve t'i përshkruajnë ato: përdoren dhe materialet përbërëse. Shkruani në dërrasë të zezë materialet e tyre: druri dhe letra. A e dinë ata ndryshimin midis tyre. Merrni disa përgjigje dhe në fund shpjegoni se druri është material natyror dhe letra është material i krijuar nga njeriu. Bashkë me nxënësit jepni shembuj të tjerë të materialeve natyrorë ose jo.

Aktiviteti 1. Objektet dhe materialet

Ky aktivitet ka për qëllim t'u mësojë nxënësve se objekte të ndryshme mund të ndërtohen nga i njëjti material. Duke ndjekur shembullin e dhënë ata do të plotësojnë tabelën. Shkruajeni tabelën në dërrasë të zezë dhe ngrini nga një nxënës për çdo material. Në fund, bashkë me nxënësit, jepuni përgjigje pyetjeve.

Nxënësit mund të plotësojnë tabelën në libër me objekte të tjera.

Ju mund ta jepni këtë si detyrë shtëpie.

Përgjigje të mundshme: druri – raftet, karrigia, korniza, kitara, varka, etj.; plastika – lodrat e ndryshme, bishtat e tiganëve, govata, koshi, etj; metali – kanaçja, monedhat, vëthët, tiganët, etj.; leshi – kapuç, papuçe, qilima, etj.; letra – librat, pasaportat, biletat, harta, paketimet e ushqimeve, etj.; xhami – dritaret, syzet, llambat, etj.

Pyetjet në fund të aktivitetit diskutojini bashkë me nxënësit.

Aktiviteti 2. Lënda e parë dhe përpunimi

Shpjegoni me pak fjalë se çdo material me të cilin ndërtohen objektet gjendet në natyrë dhe këto quhen lëndë të para. Lëndët e para përpunohen nëpër procese përpunimi, të thjeshta apo jo, për të përfutur materialet që ne njohim. Punoni bashkërisht, në dërrasë të zezë, dy pikat e aktivitetit.

Përgjigje të mundshme:

- *Kolona e parë është ajo e materialeve; kolona e dyta e lëndëve të para.*
- *Druri → pemët; metali → minerali; xhami → rëra; plastika → nafta; copa → bima e pambukut.*
- *Përpunimi i drurit dhe bimës së pambukut mund të realizohet në mënyrë artizanale. Të tjerat janë procese të vështira që kërkojnë mjete dhe vende të specializuara.*

Aktiviteti 3. Në shtëpinë tuaj

Përshkrimi i objekteve të lidhet me materialet përbërëse, origjinën e tyre si dhe funksionin që ato kanë.

Këtë aktivitet jepeni si detyrë shtëpie.

Mësimi 2 OBJEKTET PREJ DRURI – Teori

Detyra për t'u realizuar:

- Të lexohet me kujdes mësimi mbi drurin dhe përdorimin e tij.
- T'i jepet përgjigje pyetjeve dhe diskutimeve tek aktivitetet e mësimin të ditës.

Materialet: libri i nxënësit, faqe 8 - 9.

Objektiva për t'u realizuar:

- Të njihen me rëndësinë e drurit.
- Të përshkruajnë disa nga objektet e drurit dhe t'i ndajnë ato sipas disa kategorive.
- Të njihen me disa nga materialet zëvendësuese të drurit dhe arsyet e zëvendësimit të tij.
- Të hulumtojnë për objekte të ndërtuara dikur me dru.

Përsëritje

Nisur nga detyrat e shtëpisë, si dhe nga objektivat kryesore të përmendura tek libri i mësuesit, bëni një kontroll rreth njohurive të mësuara gjatë orës së kaluar, kontroll që mund të jetë individual apo në grup. Nxitni diskutime në klasë rreth përgjigjeve të detyrave të shtëpisë me anë të shembujve të ndryshëm rreth objekteve që ju ndihmojnë të flini, ushqeheni dhe mësoni. Ju mund të ngrini tre nxënës për secilën nga aktivitetet. Përgjigjet e tyre shkruajini në dërrasë të zezë dhe nxënësit e tjerë të plotësojnë apo bëjnë vërejtje rreth tyre.

Veprimtari në klasë për kuptimin e mësimit dhe të riprodhimit Përdorimi i drurit

Niseni mësimin duke cituar kuriozitetin. Pemët janë lëndët e para për rreth 5000 produkte, ku ndër më të rëndësishmit është druri.

Zhvilloni një konkurs në klasë me mënyrat e përdorimit të drurit në jetën tonë. Nxitini nxënësit të përmendin përdorimin e drurit jo vetëm si material ndërtimi për objekte “të vogla”, por edhe për objekte si: ura, shtëpi, varka, shina hekurudhe, tavane, dysheme, etj. Gjithashtu theksoni se drurin e përdorim për ngrohje apo gatim. *Cila është më e mirë: pica e pjekur në furrë druri apo në furrë me gaz?* Diskutoni bashkë me nxënësit.

Zëvendësimi i drurit.

Shpjegoni me pak fjalë se zëvendësimi i drurit ka ardhur si rezultat i zhvillimit të teknologjisë, i cili ka bërë të mundur krijimin e materialeve të reja apo përmirësimin e atyre ekzistuese. Këto materiale në shumë raste mund të jenë me veti më të mira krahasuar me vetitë e drurit. Jepni disa shembuj konkretë.

Aktiviteti 1. Objekte druri në jetën e përditshme

Shembujt e dhënë nga nxënësit gjatë zhvillimit të konkursit, të grupohen sipas kategorive të dhëna në tabelë.

Plotësimin e tabelës bashkë me pyetjen mund ta jepni si detyrë shtëpie.

Aktiviteti 2. Zëvendësimi i drurit

Nxënësit të shikojnë figurat dhe të diskutojnë rreth tyre. Theksoni se pavarësisht vetive që mund të kenë materialet, përzgjedhja e tyre shpesh bëhet sipas pëlqimit dhe preferencave të gjithsecilit.

Plotësimin e katrorëve jepeni si detyrë shtëpie.

Aktiviteti 3. Shpikjet e para

Shpjegoni me pak fjalë, se shumë nga shpikjet e para janë bërë me dru. Por në shumë raste, druri nuk përdoret më si shembujt në figurë: rrotat tashmë bëhen me metal dhe gomë, aeroplani mbulohet me alumin.

Nxënësit t'i përgjigjen pyetjes në fund të aktivitetit si detyrë shtëpie.

Për të realizuar këtë detyrë, nxënësit duhet të pyesin të rriturit apo të bëjnë kërkime në internet.

Përgjigje të mundshme: nëndetësja e parë ka qenë me dru, “mouse i kompjuterit”, etj.

Mësimi 3 PËRDORIMI I DRURIT – Teori

Detyra për t'u realizuar:

- Të lexohet me kujdes mësimi mbi përpunimin e drurit.
- T'i jepet përgjigje pyetjeve dhe diskutimeve tek aktivitetet e mësimit të ditës.

Materialet: libri i nxënësit, faqe 10 - 11.

Objektiva për t'u realizuar:

- Të njihen me disa nga mënyrat e përpunimit të drurit.
- Të përshkruajnë disa nga veglat e punimit të drurit.
- Të njihen me letrën si nënprodukt i drurit dhe të përshkruajnë disa nga përdorimet e saj.
- Të kuptojnë rëndësinë e proceseve të riciklimit dhe ripërdorimit.

Fjalor: riciklim, ripërdorim.

Ju mund të shfrytëzoni një nga orët e lira për të bërë një vizitë në një nga punishtet e përpunimit të drurit apo zdruktharitë. Qëllimi i ekskursionit është njohja nga afër me disa mjete dhe vegla të përpunimit të drurit.

Përsëritje

Nisur nga detyrat e shtëpisë, si dhe nga objektivat kryesore të përmendura tek libri i mësuësit, bëni një kontroll rreth njohurive të mësuara gjatë orës së kaluar, kontroll që mund të jetë individual apo në grup. Kontrolloni skicat dhe mund të bëni një përzgjedhje të punimit/eve më të mirë/a. Nxënësit të tregojnë se cilin objekt pëlqejnë më shumë, duke dhënë arsyet e tyre.

Veprimtari në klasë për kuptimin e mësimit dhe të riprodhimit

Përpunimi i drurit

Nëse e keni zhvilluar ekskursionin, mund t'i pyesni nxënësit rreth përshtypjeve të tyre dhe njohurive që ata morën.

Bashkë me nxënësit listoni disa vegla të punimit të drurit dhe përshkruani funksionet e tyre. Më pas shpjegoni se druri përpunohet edhe në procese më “të ndërlikuara”, si rezultat i të cilave përftohet letra. Diskutoni së bashku me nxënësit për objektet të ndërtuara me letër dhe diskutoni rreth përdorimit të tyre. Shkruani disa prej tyre në dërrasë të zezë, për t'i përdorur në aktivitetin 2.

Ruajtja e pemëve

Citoni përsëri kuriozitetin e mësimit të parë mbi përdorimin e pemëve dhe tregoni pse është mjaft e rëndësishme që ne t'i ruajmë pyjet. Përfshini edhe nxënësit në diskutim mbi arsyet e ruajtjes së pemëve që lidhen mjaft ngushtë me mbrojtjen e mjedisit.

Po nxënësit, a mund të kontribuojnë në ruajtjen e pyjeve? Përgjigja është po: nëpërmjet kursimit, mos shpërdorimit, riciklimit dhe ripërdorimit. Ndaluni pak më gjatë në shpjegimin e dy koncepteve të fundit.

Aktiviteti 1. Veglat për punimin e drurit

Nxënësit të shikojnë figurat dhe të diskutojnë rreth tyre. Plotësoni përshkrimet e figurave sipas shembullit.

Pyetjen në fund të aktivitetit mund ta jepni si detyrë shtëpie.

Aktiviteti 2. Produktet e letrës

Shembujt e dhënë nga nxënësit dhe të shënuara në dërrasën e zezë, të grupohen sipas kategorive të dhëna në tabelë.

Plotësimin e tabelës mund ta jepni si detyrë shtëpie.

Aktiviteti 3. Shpikjet e para

Ky aktivitet lidhet me veprimet tona në ruajtjen e pemëve.

Pyetjet në fund të aktivitetit jepini si detyrë shtëpie.

Përgjigje të mundshme: mobiliet e vjetra mund të kalojnë në procese të ndryshme përpunimi, si lëmim, lyerje; mund të përdoren si lëndë ngrohëse.

Mësimi 4 METALET DHE PËRDORIMI I TYRE – Teori

Detyra për t'u realizuar:

- Të lexohet me kujdes mësimi mbi metalet.
- T'i jepet përgjigje pyetjeve dhe diskutimeve tek aktivitetet e mësimi të ditës.

Materialet: libri i nxënësit, faqe 12 - 13.

Objektiva për t'u realizuar:

- Të njihen me përdorimin e metaleve gjatë historisë së njerëzimit.
- Të dallojnë objektet prej metali.
- Të përshkruajnë disa nga veglat prej metali.
- Të praktikojnë përdorimin e objekteve prej metali në veprimet tona të përditshme.

Fjalor: material i fortë, material i qëndrueshëm.

Kërkojuni nxënësve të sjellin copa të vogla nga veshje të vjetra.

Përsëritje

Nisur nga detyrat e shtëpisë, si dhe nga objektivat kryesore të përmendura tek libri i mësuesit, bëni një kontroll rreth njohurive të mësuara gjatë orës së kaluar, kontroll që mund të jetë individual apo në grup. Nxitni diskutime në klasë rreth përgjigjeve të detyrave të shtëpisë me anë të shembujve të ndryshëm rreth objekteve prej letre. Ju mund të ngrini tre nxënës për secilën nga aktivitetet. Përgjigjet e tyre nxënësit t'i shkruajnë në dërrasë të zezë apo t'i thonë me gojë dhe nxënësit e tjerë të plotësojnë apo bëjnë vërejtje rreth tyre.

Veprimtari në klasë për kuptimin e mësimi dhe të riprodhimit

Pak histori

Niseni mësimin, duke shkruar në dërrasë të zezë “Epoka e Bronzit” dhe “Epoka e hekurit”. Pyetini nxënësit se çfarë dinë ata mbi këto epoka dhe emërtimet e tyre. Plotësoni njohuritë e tyre me fakte dhe të dhëna rreth përdorimit të metaleve. Metali i parë i përdorur ishte bakri, sepse ai gjendej në sipërfaqe dhe i papërzier me metale të tjera. Por ai ishte paksa i butë dhe njerëzit e bashkuan me kallaj dhe përftuan bronzin. Veglat e para prej bronzi i dhanë emrin epokës së tij. Më pas njerëzit mësuuan të shkrijnë hekurin dhe më vonë ta përpunojnë atë, duke e kthyer në çelik, mjaft i përdorshëm sot.

Përdorimi i metaleve

A e dini sa është numri i metaleve? Lërinë nxënësit të diskutojnë të lirë rreth kësaj teme. Nxitini të përmendin disa dhe çelikut, bakrin, arin dhe aluminin shënojinë në tabelë.

Sot ekzistojnë rreth 86 metale, por para shekullit XIX, numri i tyre ishte vetëm 24. Me zhvillimin e teknologjisë njeriu krijon materiale të reja, përfshirë edhe metalet. Metalet

e reja formohen nga kombinime të metaleve ekzistuese. Megjithatë objektet që na rrethojnë, më së shumti përbëhen nga metale që njihen prej kohësh. Përshkruani me pak fjalë metalet e shënuara në tabelë dhe jepni disa shembuj të përdorimit të tyre. Përfshini edhe nxënësit në diskutim.

Aktiviteti 1. Përdorimet e metaleve

Aktiviteti i ndihmon nxënësit të kuptojnë rëndësinë që kanë metalet në jetën e përditshme. Ne bëjmë shumë veprime duke përdorur objekte prej metali.

Plotësimin e tabelës mund ta jepni si detyrë shtëpie. Nxënësit të ndjekin shembullin e dhënë për ta plotësuar.

Përgjigje të mundshme: shtrëngoni dadot – dado, pinca, çelës anglez; pini lëngje – kanaçe; hani drekë – lugë, pirun, thikë; gatvani – tenxhere, tigan, sobë; Mësoni/argëtoheni – patina, kompjuter; udhëtoni – makinë, biçikletë, aeroplan; hapni derën – çelës, doreza e derës.

Pyetja: Metalet zakonisht janë me ngjyrë të argjendtë, bakri me ngjyrë të kuqe dhe ari me të verdhë. Prandaj objektet e mësipërme në përgjithësi janë me ngjyrë të argjendtë.

Aktiviteti 2. Veglat prej metali

Shikoni figurat dhe diskutoni rreth ndarjes së veglave prej metali në grupe. Duke pyetur nxënës të ndryshëm plotësoni tabelën.

Plotësimin e katrorëve dhe pyetjet në fund të librit jepini si detyrë shtëpie.

Përgjigje e mundshme: 1. ngjyrë të njëjtë, janë prerëse, shpuese apo gërmuese (përveç metrit). Materiali përbërës i tyre mund të jetë çelik, pasi ai është mjaft i fortë.

Mësimi 5 VESHJET DHE MATERIALET E TYRE – Teori

Detyra për t'u realizuar:

- Të lexohet me kujdes mësimi mbi veshjet.
- T'i jepet përgjigje pyetjeve dhe diskutimeve tek aktivitetet e mësimi të ditës.

Materialet: libri i nxënësit, faqe 14 – 15, copa pambuku, leshi, poliestër, etj.

Objektiva për t'u realizuar:

- Të njiheni me disa nga materialet e veshjeve tona.
- Të dalloni origjinën e fibrave të ndryshme.
- Të përshkruani rrugën nëpër të cilën përpunohet pambuku, leshi dhe poliestra.

- Të praktikoheni duke skicuar veshjen tuaj të preferuar.

Ju mund të shfrytëzoni një nga orët e lira, për të bërë një vizitë në një nga punishtet e tezgjahut, për të parë nga afër proceset e përpunimit të leshit dhe makineritë që përdoren.

Përsëritje

Nisur nga detyrat e shtëpisë, si dhe nga objektivat kryesore të përmendura tek libri i mësuesit, bëni një kontroll rreth njohurive të mësuar gjatë orës së kaluar, kontroll që mund të jetë individual apo në grup. Kontrolloni skicat dhe mund të bëni një përzgjedhje të punimit/eve më të mira.

Veprimtari në klasë për kuptimin e mësimit dhe të riprodhimit

Veshjet

Kur shikoni një person të panjohur, përshtypjen e parë për të e krijoni duke u bazuar te veshja dhe sjellja e tij. Një veshje e pastër dhe e rregullt, pasqyron po këto tipare të personit që e ka veshur.


Veshja ka rëndësi estetike, por funksioni më i vlefshëm i saj është të na mbrojë kushtet klimaterike. Lërimi nxënësit të diskutojnë të lirë për rastet kur ata veshin rroba të ndryshme. Përcaktoni një nxënës që të shkruajë përgjigjet në dërrasën e zezë. Bëni një përmbledhje mbi rëndësinë e veshjes në situata të caktuara. Njerëzit anë e mbanë botës, vishen ndryshe. Veshjet dallohen nga ngjyrat, modeli dhe materialet.

Fibrat

Merrni një copë dhe filloni ta prishni duke i nxjerrë fijet. Kërkoni që nxënësit të bëjnë të njëjtin veprim me copat që kanë sjellë. Fillni e nxjerrë nga copat, u thoni nxënësve ta vëzhgojnë. Ata do të vënë re se ajo përbëhet nga fije akoma më të holla që janë fibrat. Fibrat janë lëndët e para të prodhimit të copave. Diskutoni bashkë me nxënësit për origjinën e tyre, natyrore ose sintetike, duke i nxitur ata të japin shembuj.

Aktiviteti 1. Origjina e fibrave

Sugjerohet që nxënësit të shikojnë skemën dhe të diskutojnë rreth saj. Ju mund të ngrini një nxënës në klasë për ta plotësuar dhe të tjerët të plotësojnë në libër.



Pyetjen në fund të aktivitetit, mund ta jepni si detyrë shtëpie.

Përgjigje: në anën e fibrës sintetike. Kjo fibër quhet mëndafsh pasi ka veti të ngjashme me të.

Aktiviteti 2. Origjina e copave

Hapni librin dhe i lini nxënësit të shikojnë figurat dhe të tregojnë se çfarë fibrash marrim nga elementët e paraqitur në figurë.

Përsërisni edhe njëherë së bashku me nxënësit, rrugën që përshkon fibra për t'u bërë copë dhe diskutoni për secilën nga figurat proceset e përpunimit. Nxënësit mund të kenë pak vështirësi më figurën e naftës, por ata janë mjaft të familjarizuar me përpunimin e pambukut dhe leshit, pasi janë traditat tona. Prandaj këtë aktivitet trajtoheni si temë të lirë.

Përgjigjet e mundshme: 1. Veshjet e brendshme bëhen me pambuk, pasi pambuku na mban freskët në verë dhe ngrohtë në dimër. Gjithashtu ai thith shumë mirë djersën. 2. Veshjet prej leshi janë të "ashpra" por shumë të ngrohta. 3. Çanta e shkollës bëhet me poliestër. Kjo fibër nuk mund të prodhohet në mënyrë artizanale, pasi ajo nxirret nga nafta.

Aktiviteti 3. Veshja juaj e preferuar

Orientojini nxënësit që për këtë aktivitet nuk është e nevojshme të skicojnë të gjithë veshjen. Mjafton të zgjedhin një element të saj si: kapele, dorashka, rrip, bluzë dhe pse jo shami dore.

Skicimin e një modeli veshjeje jepeni si detyrë shtëpie.

Mësimi 6 PUNË PRAKTIKE

Detyra për t'u realizuar:

- Të lexohet me kujdes mësimi praktik mbi prodhimin e dorashkave nga trikot e leshit të vjetra.
- Të ndiqen hapat për realizimin e tyre.

Materialet: libri i nxënësit faqe 16, bluzë leshi e ngjeshur nga larja që nuk përdoret më, gërsërë, lule të vogla lecke, kopsa, zbukurime, shirita copash, gishtëz, fill.

Objektiva për t'u realizuar:

- Të praktikojnë krijimin e një veshjeje.
- Të kuptojnë rëndësinë e ripërdorimit të veshjeve të vjetra.

Përsëritje

Nisur nga detyrat e shtëpisë, si dhe nga objektivat kryesore të përmendura tek libri i mësuësit, bëni një kontroll rreth njohurive të mësuara gjatë orës së kaluar, kontroll që mund të jetë individual apo në grup. Kontrolloni skicën dhe mund të bëni një përzgjedhje të punimit/eve më të mira. Nxënësit të tregojnë se cilin objekt pëlqejnë më shumë duke dhënë arsyet e tyre.

Ky mësim përmban një aktivitet që ka të bëjë me ripërdorimin e një trikoje të vjetër leshi dhe përfitim e një palë dorashkash të reja.

Aktivitet

Veshjet kanë procese të ndryshme larjeje, bazuar në vetitë e materialeve të tyre. Pyetini nxënësit nëse kanë futur një bluzë leshi në lavatriçe dhe e kanë prishur atë. Çfarë kanë bërë me atë bluzë? Për të realizuar këtë aktivitet kërkoni ndihmën e prindërve. Kujdes! Trikoja duhet të jetë e tillë sa të mos duket punimi, pra të duket si një e tërë. Nëse punimi nuk është prishur tërësisht, futeni trikon në lavatriçe me ujë të nxehtë.

Ndiqni hapat siç tregohen në figurë. Në fund mund të shtoni zbukurime të ndryshme sipas dëshirës dhe fantazisë tuaj.

Kjo punë praktike mund të jepet si detyrë shtëpie.

Mësimi 7 PUNË PRAKTIKE

Detyra për t'u realizuar:

- Të lexohet me kujdes mësimi praktik mbi thurjen.
- Të ndiqen hapat e procesit të thurjes.

Materialet: libri i nxënësit faqe 17, një kornizë druri, një karton, një bluzë e vjetër, fill i trashë, një krehër i vogël, gërshërë, gishtëz, një gjilpërë e madhe, një brisk, vizore dhe laps.

Objektiva për t'u realizuar:

- Të praktikojnë thurjen.
- Të kuptojnë rëndësinë e ripërdorimit të veshjeve të vjetra.
- Të rikujtojnë përdorimin e veglave të punës.
- Të vënë në praktikë ripërdorimin e objekteve të vjetra.

Ky mësim përmban një aktivitet që ka të bëjë me realizimin e procesit të thurjes në mënyrë artizanale.

Aktivitet

Për të realizuar këtë aktivitet kërkoni ndihmën e prindërve, jo vetëm për të realizuar procedurën, por edhe për të gjetur materialet e nevojshme.

Ndiqni hapat siç tregohen në figurë.

Kjo punë praktike përdor disa vegla si gjilpërë, gërshërë, kornizë druri, karton etj. Pyetini nxënësit për përdorimin e tyre, duke bërë edhe një përsëritje të veglave dhe objekteve me materiale të ndryshme.

Gjithashtu, kjo punë praktike përdor copa të vjetra, të cilat nxënësit mund t'i ripërdorin. Kujtoni bashkë me nxënësit pse është i rëndësishëm ripërdorimi dhe riciklimi. Në këtë mënyrë ata i kanë dhënë përgjigje edhe pyetjeve në fund të aktivitetit.

Kjo punë praktike mund të jepet si detyrë shtëpie.

Mësimi 8 USHTRIME

Detyra për t'u realizuar:

- Të zgjidhen ushtrimet dhe realizohet aktiviteti.

Materialet: libri i nxënësit faqe 18

Objektiva për t'u realizuar:

- Të testojnë njohuritë e kapitullit nëpërmjet zgjidhjes së ushtrimeve.

Ky mësim përbëhet nga një aktivitet dhe disa ushtrime. Shërben për të përmbledhur njohuritë e përfituara në këtë kapitull.

Aktivitet

Figura paraqet një dhomë fëmijësh, në të cilën ndodhen objekte të ndryshme. Pyetini nxënësit për objektet që dallojnë në figurë si edhe për materialin e tyre. Ndërkohë që ata tregojnë materialin e një objekti, pyetini se çfarë materiali ka ky objekt në shtëpitë e tyre. Sipas tyre, çfarë objektësh i mungojnë dhomës së paraqitur në figurë dhe me çfarë materiali përbëhen ato? Thojini nxënësve të tregojnë disa objekte që ndodhen në shtëpitë e tyre dhe materialin me të cilin ato përbëhen.

Pyetini nxënësit, pse materiali më i përdorur është druri.

Ushtrime

1. Plotësoni vendet bosh.

- a) pemët
- b) nënprodukt

c) vegla metali

d) ripërdorim apo riciklojmë

2. E vërtetë apo e gabuar.

a) V, b) G, c) V, d) G

3. Ne do të prodhohim një objekt prej çeliku sepse është i fortë.

Kapitulli II: Objektet dhe paraqitja e tyre grafike

Mësimi 1 OBJEKTET DHE FIGURAT GJEOMETRIKE – Teori

Detyra për t'u realizuar:

- Të lexohet me kujdes mësimi mbi objektet dhe figurat gjeometrike.
- T'i jepet përgjigje pyetjeve dhe diskutimeve tek aktivitetet e mësimin të ditës.

Materialet: libri i nxënësit faqe 20 – 21.

Objektiva për t'u realizuar:

- Të njohin tiparet e objekteve për skicim.
- Të dallojnë figurat gjeometrike në natyrë.
- Të praktikohen me gjetjen e figurave gjeometrike tek objektet e krijuara nga njeriu.
- Të skicojnë figura të ndryshme gjeometrike.

Fjalor: figurë gjeometrike, skicë

Prezantim i kapitullit

Ky kapitull lidhet me përcaktimin e tipareve të objekteve si forma, gjatësia, gjerësia, lartësia etj, dhe skicimin e tyre duke përdorur mjetet matëse dhe të skicimit. Kërkojini nxënësve t'ju përmendin disa figura gjeometrike. Figurat gjeometrike i gjejmë kudo. Shpesh, figurat gjeometrike në jetën tonë, nuk duken njëjloj siç ato shfaqen në tekstet shkollore. Por, nëse jemi më të vëmendshëm, do të çuditemi nga larmia e objekteve me formë gjeometrike që mund të gjejmë përreth.

Veprimtari në klasë për kuptimin e mësimin dhe të riprodhimit

Tiparet e objekteve

Në dërrasën e zezë krijoni një tabelë me 5 kolona me këto emërtime: Objekti – Forma – Materiali – Përmasa – Përdorimi.

Fillimisht ju mund të pyesni nxënësit për format e objekteve që shikojnë në klasë apo kanë në shtëpi. Po kështu, duke iu bërë pyetje nxënësve rreth objekteve, plotësoni të gjithë tabelën. Në fund bëni një përmbledhje.

Figurat gjeometrike

Më pas tregojini atyre se objektet që ata përmendën më lart, kanë formën e disa figurave gjeometrike si drejtkëndëshi, rrethi, trekëndëshi, forma vezake (ovale). Objektet e listuar mund të kenë më shumë se një figurë gjeometrike, si lapsi që ka formë cilindrike, por goma që ndodhet në fund të tij ka formën e rrethit; lëpirësja ka formë të rrumbullakët, por shkopi që e mban atë ka formën e një cilindri. Kujtojini atyre se figurat gjeometrike përdoren edhe për të vizatuar/përshkruar tiparet e njeriut.

Aktiviteti 1. Figurat gjeometrike në natyrë

Ndani nxënësit në grupe dhe në sajë të numrit më të madh të gjetur të figurave gjeometrike në natyrë, shpallni grupin fitues. *Disa shembuj të tjerë: forma e rrumbullakët tek petalet e luleve, rrathët e drurëve, të cilët na tregojnë edhe moshën e pemëve, te veshët e disa kafshëve si koala; forma trekëndore te sqepi i shpendëve; forma cilindrike te drurët e pemëve; forma e gjashtëkëndëshit te rrjeta e merimangës; forma vezake (ovale) te gjethet etj.*

Aktiviteti 2. Gjeni figurat gjeometrike tek objektet

Udhëtimi në makinë ju vë në kontakt me shumë forma gjeometrike. Semaforët, tabelat e qarkullimit, rrotat dhe timoni i makinës. Po të hedhim një sy jashtë xhamit të makinës, do të shikojmë mjaft ndërtesa ku forma e drejtkëndëshit dhe katrorit mbizotëron. Figurat: *dorashkat - drejtkëndësh; kubat - katrorë; kapelja - trekëndësh; syzet - të rrumbullakëta; tavolina - drejtkëndësh; furça - cilindër; avioni - trekëndësh dhe topi - i rrumbullakët.*

Përgjigje të mundshme:

1. Ndër objektet e mësipërme, kapela, syzet, tavolina, janë ato të cilat mund të kenë forma të tjera. Kapela mund të jetë në formën e një drejtkëndëshi, ose rrethi; syzet katrore, drejtkëndëshe ose ovale; tavolina e rrumbullakët, katrore, ovale. Kubi nuk mund të jetë në formë tjetër, sepse kur luajmë faqet nuk kanë probabilitet të njëjtë.

Aktiviteti 3. Praktikohuni duke vizatuar

Skicimin mund ta jepni si detyrë shtëpie.

Nxënësit mund të argëtohen dhe praktikohen duke vizatuar format gjeometrike siç janë dhënë në figurë, ose të bëjnë një vizatim ku të përdorin këto forma gjeometrike. Mund t'u sugjeroni të vizatojnë një shtëpi, e cila ka formë katrore, dera dhe dritaret formë drejtkëndëshi, çatia formë trekëndëshi ose trapezi.

Mësimi 2 MJETET MATËSE DHE SKICIMI I OBJEKTEVE – Teori

Detyra për t'u realizuar:

- Të lexohet me kujdes mësimi mbi mjetet matëse.
- T'i jepet përgjigje pyetjeve dhe diskutimeve tek aktivitetet e mësimit të ditës.
- Të lexohen dhe zbatohen procedurat e vizatimit në mësimin praktik.

Materialet: libri i nxënësit faqe 22 – 23, vizore, metër, raportor, kompas, vizore të lakuar, lapsa me ngjyra.

Objektiva për t'u realizuar:

- Të njihen me mjete matëse të thjeshta dhe me mënyrat e përdorimit të tyre.
- Të mësojnë si realizohet një skicim hap pas hapi.
- Të skicojnë objekte duke përdorur mjetet matëse dhe ato të skicimit.

Përsëritje

Nisur nga detyrat e shtëpisë, si dhe nga objektivat kryesore të përmendura tek libri i mësuesit, bëni një kontroll rreth njohurive të mësuara gjatë orës së kaluar, kontroll që mund të jetë individual apo në grup. Zgjidhni tre nxënës për të kontrolluar detyrën e shtëpisë mbi vizatimin me figura gjeometrike. Pyetini se cilat janë tiparet e objektit që ata kanë matur. Kontrolloni skicën dhe mund të bëni një përzgjedhje të punimit/eve më të mira

Veprimtari në klasë për kuptimin e mësimit dhe të riprodhimit

Mjetet matëse

Bëni një lojë. Pyetini nxënësit për disa përmasa të objekteve në klasë si fletorja, lapsi, banka, dërrasa e zezë, etj. Shënojini përgjigjet në dërrasë. Më pas duke përdorur mjetet matëse matini bashkërisht objektet e përzgjedhura. Rezultatet shënojini përsëri në dërrasë dhe bëni krahasimin e matjeve.

Mbështetur në këto krahasime tregoni rëndësinë që kanë mjetet matëse për të skicuar sa më saktë një objekt. Gjithashtu orientoni nxënësit të japin shembuj të tjerë të mjeteve matëse që ata mund të kenë në shtëpi.

Skicimi i objekteve

Shpjegoni hapat që duhet të ndjekin nxënësit për të skicuar një objekt. Tregojini nxënësve që duhet të gjejnë figurat gjeometrike të objektet. Kjo do t'i ndihmojë shumë ata në procesin e skicimit. Një hap shumë i rëndësishëm janë përmasat, pra nxënësit duhet të matin gjerësinë, gjatësinë, lartësinë apo madhësinë e këndit të rrethit. Skicat janë shumë të rëndësishme. Zhvillimi i teknologjisë nuk ka mundur të zbehtë rëndësinë e skicimit të objekteve, si një hap fillestar i një dizenjimi, i zhvillimit të një ideje etj. Skicat mund t'i bëjnë shumë shpejt, në çdo kohë dhe kudo. Mjafton të nxjerrim fletoren tonë të shënimeve dhe të hedhim në letër idenë tonë. Mendimi i parë është gjithmonë i rëndësishëm.

Aktiviteti 1. Të njihemi me disa nga mjetet e matjes dhe të skicimit

Shpjegoni me pak fjalë për çfarë shërbejnë mjetet në figurë:

Kompasi na shërben për të vizatuar rrathë dhe për të matur rrezen e një rrethi; raportori për të matur kënde me madhësi të ndryshme, po gjithashtu për të vizatuar një rreth, ose gjysmërreth (varet nga forma e raportorit); vizorja e drejtë dhe e lakuar për të vizatuar vija të drejta apo me forma të ndryshme. Diskutoni mbi materialet përbërëse të mjeteve.

Pyetjen e dytë të aktivitetit 1 mund ta jepni si detyrë shtëpie

Aktiviteti 2. Si të skicojmë një biçikletë, mbështetur tek figurat gjeometrike?

Shpjegojini nxënësve paraprakisht, hapat që duhet të ndjekin për të realizuar skicimin e biçikletës. Ata duhet në fillim të përcaktojnë çfarë figurash gjeometrike gjenden tek ajo.

Skicimin e biçikletës mund ta jepni si detyrë shtëpie .

Mësimi 3 PUNË PRAKTIKE

Detyra për t'u realizuar:

- Të lexohen dhe zbatohen procedurat e vizatimit në mësimin praktik.

Materialet: libri i nxënësit faqe 24 – 25, vizore, metër, raportor, kompas, vizore të lakuar, lapsa me ngjyra, gomë, kubi rubiks.

Objektiva për t'u realizuar:

- Të dallojnë trupat gjeometrik te objektet.
- Të skicojnë trupat gjeometrik dhe objektet në formën e tyre.
- Të njihen me kubin rubiks dhe ta ndërtojnë atë.

Përsëritje

Nisur nga detyrat e shtëpisë, si dhe nga objektivat kryesore të përmendura tek libri i mësuesit, bëni një kontroll rreth detyrave të shtëpisë. Për skicën e biçikletës mund të bëni një përzgjedhje të punimit/eve më të mira.

Ky mësim përmban dy aktivitete që kanë të bëjnë me skicimin e trupave gjeometrik.

Aktiviteti 1. Vizatimi i një cilindri

Pyesni nxënësit për objekte që kanë formë cilindrike. Shpjegoni që për të vizatuar këto objekte, është e rëndësishme të dimë hapat për të vizatuar një cilindër. Bashkë me nxënësit, ndiqni hap pas hapi procedurën e shpjeguar në këtë aktivitet.

Vizatimin e objektit cilindrik mund ta jepni si detyrë shtëpie.

Aktiviteti 2. Si të ndërtojmë kubin rubiks?

Tregojuni nxënësve kubin rubiks. Pyetini ata, nëse e dinë si quhet ky kub dhe historinë e tij. Më pas, shpjegoni me pak fjalë kush e ka shpikur dhe si funksionon kubi. A di ndonjë nga nxënësit ta zgjidhë atë? Më pas shpjegoni në dërrasë të zezë hapat që duhet të ndjekim për të skicuar kubin rubiks.

Ndërtimin e tij jepeni si detyrë shtëpie.

Mësimi 4 USHTRIME

Detyra për t'u realizuar:

- Të zgjidhen ushtrimet dhe realizohet aktiviteti.

Materialet: libri i nxënësit faqe 26.

Objektiva për t'u realizuar:

- Të testojnë njohuritë e kapitullit nëpërmjet zgjidhjes së ushtrimeve.

Përsëritje

Nisur nga detyrat e shtëpisë, si dhe nga objektivat kryesore të përmendura tek libri i mësuesit, bëni një kontroll rreth detyrave të shtëpisë. Për skicën e mekanizmit dhe mund të bëni një përzgjedhje të punimit/eve më të mira.

Ky mësim përbëhet nga një aktivitet dhe disa ushtrime. Shërben për të përmbledhur njohuritë e përfituara në këtë kapitull.

Aktivitet 1. Skicimi me mjete rrethanore

Skicimin e një peme të pazakontë të vitit të ri, jepeni detyrë shtëpie.

Udhëzoni nxënësit që fillimisht të vizatojnë një trekëndësh, i cili do të shërbejë si kornizë për format e ndryshme rrethore. Në këtë mënyrë do të dalë më mirë forma e pemës së vitit të ri.

Ushtrime

Përgjigjet e mundshme:

1 a) Cilindri te kanaçet dhe kuboidi te paketimet me karton.

1 b) Sfera, forma e topit në sportin e futbollit, volejbollit, basketbollit, tenisit, pingpongut, golfit etj.

1 c) Është e rëndësishme të dihet gjatësi dhe gjerësia e vendit ku do të shtrohet tapeti.

2. 1V, 2V, 3G, 4G, 5G

Kapitulli III: Teknologjia e informacionit dhe komunikimit

Mësimi 1 OBJEKTET E KOMUNIKIMIT – Teori

Detyra për t'u realizuar:

- Të lexohet me kujdes mësimi mbi objektet e komunikimit dhe informacionit.
- T'i jepet përgjigje pyetjeve dhe diskutimeve tek aktivitetet e mësimit të ditës.
- Të ndërtojnë një telefon të thjeshtë.

Materialet: libri i nxënësit faqe 28 - 29, 2 kanaçe, spango rreth 3 metra, gozhdë apo mjet shpues për kanaçen.

Kujdes: nëse doni ta zhvilloni eksperimentin me disa grupe nxënësish, u kërkoni të sjellin me vete kanaçe dhe spango.

Objektiva për t'u realizuar:

- Të njihen me disa nga mjetet dhe mënyrat e komunikimit që njerëzit kanë përdorur në të kaluarën.
- Të përshkruajnë telefonin si mjet komunikimi.
- Të listojnë disa nga mënyrat e përdorimit të telefonit fiks dhe celular.
- Të kuptojnë funksionimin e telefonit nëpërmjet realizimit të eksperimentit.

Prezantim i kapitullit

Pyesni fillimisht nxënësit se si e kuptojnë ata termin “komunikim” dhe më pas shpjegoni se edhe biseda juaj me ta është një mënyrë e thjeshtë komunikimi. Për të kuptuar impaktin që ka komunikimi në jetën tonë, ndani klasën në dy grupe dhe emërtoni secilin grup: “Një botë me komunikim” dhe “Një botë pa komunikim”. Shkruani përgjigjet në tabelë dhe krahasoni rezultatet. Gjithashtu, duke shpjeguar rëndësinë e komunikimit, pyesni nxënësit për objektet që na ndihmojnë për të komunikuar dhe shkëmbyer informacion. Nga përgjigjet e tyre, nënvizoni faktin se telefoni, kompjuteri dhe televizori, janë mjetet më të përdorshme të komunikimit dhe informacionit në ditët tona. Shpjegoni se edhe pse teknologjia ka ndikuar në zhvillimin e shumë objekteve të komunikimit, ne përdorim edhe mjete më të thjeshta komunikimi si flamujt, bilbilat, megafoni, shenja apo simbole etj.

Veprimtari në klasë për kuptimin e mësimit dhe të riprodhimit

Pak histori

Komunikim ka patur edhe në shekujt e mëparshëm, thjesht ai është bërë më cilësor dhe më i shpejtë në sajë të zhvillimit të teknologjisë. Nxënësit të rendisin disa objekte teknologjike që ata përdorin për të komunikuar më njëri-tjetrin. Përgjigjet e tyre i shkruani në dërrasë

me një emërues të përbashkët “Komunikimi në shekullin XXI”. Zgjidhni një periudhë të hershme dhe “hiqni paralelet” rreth mënyrave të komunikimit në shekullin XXI. Diskutoni së bashku me nxënësit për kohën që i nevojitej një letre për t’u dërguar.

Telefoni

Telefoni është bërë një mjet shumë i domosdoshëm për të komunikuar me njëri-tjetrin. Me zhvillimin e teknologjisë, kanë ndryshuar edhe telefonat. Në fillim flisnim nga kabina e Postës, më pas me telefonat fiks në shtëpi, tashmë kemi telefonat celular nga më i thjeshti, tek ai që ka internet , e ai me “touch screen”.

Aktiviteti 1. Si ka ndryshuar komunikimi?

Shikoni figurat dhe diskutoni bashkë me nxënësit rreth domethënies së tyre. Jepini së bashku përgjigje pyetjes së parë të këtij aktiviteti.

Përgjigje të mundshme: Daullja përdorej për të lajmëruar një ngjarje të papritur; tymi për të treguar rrezik; pëllumbi dhe telegrafi për të dërguar mesazhe; radio dhe telefoni komunikojnë me zë. Sigurisht, ky i fundit është mjeti më i përdorshëm në ditët e sotme.

Pyetjen në fund të këtij aktiviteti jepeni si detyrë shtëpie.

Përgjigje të mundshme: Megjithëse teknologjia është zhvilluar së tepërmi, këto mënyra komunikimi përdoren ende në situata të caktuara: zjarri në situata ku nuk mund të komunikohet me mënyra të tjera si: kur humbet në pyll, për të lajmëruar avionin për vendin ku ndodhesh në rast rreziku, etj; telegrafi në ushtri, nëndetëse, etj.

Aktiviteti 2. Përdorimi i telefonit

Këtë aktivitet jepeni si detyrë shtëpie.

Përgjigje të mundshme: të dërgojmë mesazhe zanore apo të shkruara, të bëjmë fotografi, të xhirojmë, dëgjojmë këngë, shohim video, të lundrojmë në internet, të ruajmë informacione të ndryshme, të ruajmë numrat e telefonave shumë personave, të luajmë, të shohim kalendarin, etj.

Eksperiment: Telefon me kanaçe

Eksperimenti është një mënyrë e këndshme për ta bërë sa më argëtuese orën e mësimi. Zgjidhni disa grupe nxënësish për ta realizuar atë.

Ndiqni hapat sipas librit për të ndërtuar këtë telefon dhe shpjegojini nxënësve pse funksionon ky “telefon” i thjeshtë.

Kur tendosim spangon dhe flasim te njëra nga kanacet, zëri vibrohet përgjatë spangos së tërhequr fort, deri te kanaçja tjetër. Veshët e personit te kanaçja tjetër e kapin këtë vibrim dhe e përçojnë në tru, i cili jep komandën përkatëse të dëgjimit.

Ruajini telefonat kanaçe për t’i përdorur në mësimin 3 të këtij kapitulli.

Informacionet shitesë dhe kuriozitete përdorini për orën në vazhdim.

- Madhësia e ekranit është gjatësia e diagonales. Kur ne themi që ekrani është 42”, nënkuptojmë madhësinë e diagonales nga njëri cep i ekranit në tjetrin.
- “Mouse” i parë, i shpikur në vitin 1964, përbëhej nga druri.
- Tastiera e kompjuterit, siç e njohim ne tani, është përdorur në fillim tek makinat e shkrimit. Renditja e shkronjave ishte sipas alfabetit dhe ajo u ndryshua për dy arsye: shmangien e ngecjes së letrës tek makina e shkrimit dhe shpejtësinë në të shkruar. Mbas disa eksperimentesh renditja e sotme e shkronjave në tastierë i lejon njerëzit që të shkruajnë mjaft shpejt. Tastiera më e përhapur është QWERTY.

Mësimi 2 KOMPJUTERI DHE TELEVIZORI – Teori**Detyra për t’u realizuar:**

- Të lexohet me kujdes mësimi mbi kompjuterin dhe televizorin.
- T’i jepet përgjigje pyetjeve dhe diskutimeve tek aktivitetet e mësimi të ditës.

Materialet: Libri i nxënësit, faqe 30 – 31.

Objektiva për t’u realizuar:

- Të njihen me përdorimet dhe pjesët përbërëse të kompjuterit.
- Të mësojnë si ka ndikuar zhvillimi i teknologjisë te televizori.
- Të përshkruajnë veprimet që mund të bëjnë me kompjuterin.
- Të krahasojnë përdorimin e kompjuterit me mjete të tjera komunikimi dhe informacioni.

Përsëritje

Nisur nga detyrat e shtëpisë, si dhe nga objektivat kryesore të përmendura tek libri i mësuesit, bëni një kontroll rreth njohurive të mësuara gjatë orës së kaluar, kontroll që mund të jetë individual apo në grup. Ngrini dy nxënës që të flasin përkatësisht për dy detyrat e shtëpisë. Nxënësit e tjerë të plotësojnë me shembuj të tjerë. Cili nga nxënësit ka përmendur më shumë përdorime të telefonit?

Veprimtari në klasë për kuptimin e mësimi dhe të riprodhimit**Kompjuteri**

Pyesni nxënësit a e njohin kompjuterin dhe merrni mendimin e tyre se për çfarë përdoret ai. Disa nga përgjigjet e tyre shkruajini në dërrasë. Duke plotësuar edhe me shembuj të tjerë si: përdorimin e kompjuterëve në fushën e mjekësisë, aeronautikës, e prodhimit të makinave, të robotëve etj; nxirrni përfundimin se kompjuteri është bërë sot mjeti më i rëndësishëm i shkëmbimit të informacionit.

Televizori

Nxisni një debat në klasë rreth mjeteve që argëtojnë më shumë nxënësit në shtëpi. Me siguri televizori është zgjedhja e shumicës. Shpjegoni me pak fjalë si funksionon televizori duke u nisur nga xhirimi me anë të kamerave. Theksoni se televizori, radio, gazeta janë mjete komunikimi masive. Nëpërmjet tyre ne mësojmë çfarë ndodh kudo në botë në një kohë shumë të shkurtër. Diskutoni se përveç informacioneve, çfarë na ofron tjetër televizori.

Aktivitet 1. Përdorimi i kompjuterit

Ky aktivitet na tregon se sa i rëndësishëm është kompjuteri. Shumë veprime që ne i bëjmë me mjete të ndryshme komunikimi apo informacioni, mund t'i bëjmë vetëm me kompjuter.

Shpjegoni shembullin e dhënë dhe sipas tij nxënësit do plotësojnë të tjerat në vazhdim.

Këtë aktivitet jepeni si detyrë shtëpie.

Përgjigje të mundshme: 2. televizori, kamera, telefon; 3. telefon, postë, telegram, faks; 4. radio, televizor, iPod, CD palyer, magnetofon; 5. Revista, gazetë, libër, enciklopedi, pyes të tjerët; 6. telefon, dërgoj letra me postë, faks; 7. vizatoj, skicoj me mjete të thjeshta skicimi.

Aktivitet 2. Pjesët e kompjuterit

Ky aktivitet lidhet me disa pjesë përbërëse të kompjuterit dhe funksionin që ato kanë.

Përgjigje të mundshme:

Monitori: televizor, telefon, mikrovala, kamera, aparati fotografik, makina llogaritësi, ora elektronike etj; xham, metal, plastikë.

Tastierë: nuk janë sipas alfabetit, por sipas renditjes QWERTY; telefoni, makina e shkrimit, makina llogaritëse, piano, telekomanda e televizorit dhe e lojërave etj.

Mouse: pajisja që kontrollon lëvizjen e kursorit në ekran, jep komanda; është i sheshtë në formë drejtkëndëshe, katrore, jepni komanda me anë të lëvizjes së gishtit. ***CD:*** për të ruajtur këngë, video, informacione të ndryshme; plastikë.

Aktivitet 3. Si kanë ndryshuar televizorët

Diskutoni me nxënësit për llojin e televizorit që ata kanë në shtëpi. Shpjegoni si ka evoluar televizori me zhvillimin e teknologjisë.

Pyetjet e këtij aktiviteti jepeni si detyrë shtëpie.

Mësimi 3 MJETET E THJESHTA TË KOMUNIKIMIT

Detyra për t'u realizuar:

- Të lexohet me kujdes mësimi mbi mjetet e thjeshta të komunikimit.
- T'i jepet përgjigje pyetjeve dhe diskutimeve tek aktivitetet e mësimi të ditës.

Materialet: libri i nxënësit faqe 32 – 33.

Objektiva për t'u realizuar:

- Të mësojnë rreth flamurit semafor si mjet i thjeshtë komunikimi.
- Të përshkruajnë disa mjete komunikimi që përdoren në sporte të ndryshme.
- Të njihen me mjetet e thjeshta të komunikimit në profesione të ndryshme.

Përsëritje

Nisur nga detyra e shtëpisë, si dhe nga objektivat kryesore të përmendura tek libri i mësuesit, bëni një kontroll rreth njohurive të mësuara gjatë orës së kaluar, kontroll që mund të jetë individual apo në grup. Pyesni dy nxënës për detyrat e shtëpisë. Kontrolloni përgjigjet e nxënësve për ndikimin e teknologjisë në sasinë dhe cilësinë e informacionit të marrë nga televizorët, si edhe diskutoni për programet e tyre të preferuara. Nxënësit e tjerë mund të shtojnë në lidhje me detyrën e veprimeve në kompjuter.

Ky mësim përmban tre aktivitete që kanë të bëjnë me përdorimin e mjeteve të thjeshta si flamur, bilbil, karton, radio, etj, si mjete të thjeshta komunikimi.

Veprimtari në klasë për kuptimin e mësimi dhe të riprodhimit

Aktiviteti 1. Flamujt që flasin

Pyetini nxënësit si do të komunikonin ata nëse nuk do të mund të flisnin. Si do të komunikonin ata? A dinë ata mënyra të tjera komunikimi pa përdorur, telefonin, televizorin, kompjuterin etj, pra objekte teknologjike?

Njerëzit komunikojnë edhe me anë të shenjave apo simboleve, p.sh. personat shurdhmemec kanë gjuhën e tyre të shenjave; personat që nuk shikojnë kanë alfabetin “Braille” dhe libra të posaçëm ku ata lexojnë me anë të të prekurit.

Pyesni nxënësit si e rregullon polici trafikun, në rast se nuk ka semaforë? Një nga mjetet e thjeshta të komunikimit është edhe flamuri. Kërkojini nxënësve të japin shembuj të përdorimit të tyre.

Shikoni figurën dhe lërimi nxënësit të diskutojnë të lirë rreth saj. Më pas shpjegoni se ata janë flamuj semaforë që përdoren kryesisht nga marinarët.

Diskutoni bashkërisht përgjigjet e pyetjeve në fund të aktivitetit *Përgjigje të mundshme: 1. Në garat me makina, policët, ushtarët në luftë, në aeroport gjatë uljes së avionëve në kohë me mjegull*

2. Këto ngjyra janë mjaft të dallueshme për syrin tonë dhe tërheqin menjëherë vëmendjen. 3. Policët e trafikut, por edhe ne në jetën e përditshme.

Aktiviteti 2. Komunikimi në sport

Nxënësit të hapin librin në faqen 32 dhe të shohin figurat. Diskutimin përqendrojeni tek mënyrat e komunikimit të arbitrit.

Pyetjet ju mund t'i jepni si detyrë shtëpie.

Përgjigjet e mundshme: 1. kartoni i kuq dhe i verdhë, flamurët e arbitrave anësor, tabelën e ndërrimit të lojtarëve dhe të tregimit të kohës shtesë, mjetet në kabinën e komentatorit etj.

2. Flamuri përdoret për të treguar një pozicion në fushë në futboll, në golf, në kriket, në ski etj; si semafor në atletikë, futboll, garat me makina dhe motorra etj.

Aktiviteti 3. Profesionet dhe komunikimi

Diskutoni dhe lidhni çiftet të profesioneve që komunikojnë së bashku.

Përgjigjet e mundshme: Pilot – Kontrollor i trafikut ajror me radio; Aktor – regjisor me altoparant, mikrofon; Doktor – infermiere me biper; Futbollist – trajner me shenja; Gazetar – redaktor me telefon, kompjuter.

Çiftoni nxënësit për të realizuar kërkesën e pyetjes 2.

Mësimi 4 USHTRIME

Detyra për t'u realizuar:

- Të zgjidhen ushtrimet dhe realizohet aktiviteti.

Materialet: libri i nxënësit faqe 33 – 34.

Objektiva për t'u realizuar:

- Të testojnë njohuritë e kapitullit nëpërmjet zgjidhjes së ushtrimeve.

Përsëritje

Nisur nga detyrat e shtëpisë, si dhe nga objektivat kryesore të përmendura tek libri i mësuesit, bëni një kontroll rreth detyrave të shtëpisë.

Ky mësim përbëhet nga një aktivitet dhe disa ushtrime. Shërben për të testuar njohuritë e përfituara në këtë kapitull.

Aktivitet 1

Figura paraqet flamujt e marinës. Secila nga ato përfaqëson një shkronjë. Në vendin bosh, shkruani emrin tuaj duke skicuar flamujt e figurës.

Ushtrime

2. a) – 5, b) – 3, c) – 4, d) – 1, e) – 2

3. Pjesët e kompjuterit: monitor, tastierë, mouse, printer.

Veprimet në kompjuter: E-mail, kërkoi në internet, “download”, “log on”, faqe interneti, “log off”, dokument.

Kapitulli IV: Strukturat, forcat dhe mekanizmat

Mësimi 1 FORCAT DHE MAKINAT E THJESHTA – Teori

Detyra për t’u realizuar:

- Të lexohet me kujdes mësimi mbi strukturat dhe forcat.
- T’i jepet përgjigje pyetjeve dhe diskutimeve tek aktivitetet e mësimin të ditës.

Materialet: libri i nxënësit faqe 36 – 37, vegla të ndryshme për demonstrimin e makinave të thjeshta.

Objektiva për t’u realizuar:

- Të njohin makinat e thjeshta dhe përdorimin e tyre.
- Të dallojnë forcën e shtytjes dhe tërheqjes.
- Të praktikojnë njohjen e makinave të thjeshta duke zgjidhur situata problemore.

Fjalor: punë, makinë, mekanizëm.

Prezantim i kapitullit

Ky kapitull lidhet me strukturat, materialet përbërëse të tyre, si dhe veglat, mjetet apo makineritë që marrin pjesë në ndërtimin e tyre. Gjithashtu kapitulli prezanton disa nga makinat e thjeshta: leva, rrafshi i pjerrët, rrotulla dhe pyka, si dhe llojin e forcave që ne ushtrojmë kur i përdorim ato.

Merrni një shembull të thjeshtë për t’u shpjeguar nxënësve temat që do të trajtoni gjatë orëve të këtij kapitulli: shkollën si ndërtesë. Me pak fjalë u tregoni nxënësve se shkolla është një strukturë pasi ajo mban ngarkesa të ndryshme si nxënësit, mësuesit, bankat, karriget, peshën e vet, etj. Diskutoni me çfarë materiali është ndërtuar shkolla juaj. Më pas bëni një diskutim rreth shkollëve që nxënësit përdorin çdo ditë për t’u ngjitur për në klasë. Si do të ngjiteshin nëse nuk do të kishin shkollë. Diskutoni dhe nxisni debatin. Në fund tregoni se shkollët nuk janë gjë tjetër veçse një makinë e thjeshtë.

Veprimtari në klasë për kuptimin e mësimit dhe të riprodhimit

Makinat e thjeshta

Në vazhdim shpjegoni se makinat e thjeshta nuk janë gjë tjetër veçse mjete apo objekte që ne përdorim çdo ditë duke na i bërë të lehta veprimet tona. Rendisni disa pyetje dhe nxisni debate për të kuptuar rolin e makinave të thjeshta si: Si i hapim grilat e dritareve? Po tapat e shisheve? Me çfarë veglash e punojmë tokën? Çfarë përdorim për të prerë drurin?

Shënojini përgjigjet e nxënësve në dërrasë dhe më pas diskutoni se si do ta kryenim veprimin nëse do të mungonin veglat apo pajisjet e mësipërme. Pas diskutime, shënoni në dërrasë të zezë fjalën “makina të thjeshta” për të bërë të qartë që të gjitha shënimet në dërrasë paraqesin makina të thjeshta.

Forcat.

Ngrini dy nxënës dhe u kërkoni të shtyjnë diçka të rëndë, p.sh një bankë. Pastaj u kërkoni ta tërheqin atë. Më pas shpjegoni se në të dy rastet ata përdorën forcë për të lëvizur bankën. A e dinë ata ndryshimin midis dy veprimeve që bënë? Flisni pak për forcën e shtytjes dhe të tërheqjes. Për ilustrim dhe një kuptim mjaft të mirë të dy llojeve të forcave zhvilloni aktivitetin 1.

Aktiviteti 1. Forcat

Shikoni bashkë me nxënësit figurat. Ngrini tre prej tyre dhe secili nga ata do të gjejë përkatësisht figurën ku përdoret forca e shtytjes, forca e tërheqjes dhe të dyja së bashku. Përgjigjet të shënohen në dërrasë të zezë. Vini re nëse ka përgjigje të përbashkëta. Më pas nxënësit të tregojnë raste të tjera të përdorimit të këtyre dy forcave.

*Përgjigje të mundshme: shkopi i bejsbollit, kositja e barit, karroca – **forcë shtytëse**; grepi i peshkimit, slita dhe zinxhiri – **forcë tërheqëse**; kolovajza dhe fshesa – **forcë tërheqëse dhe shtytëse**.*

Aktiviteti 2. Makinat e thjeshta

Ky aktivitet bazohet në zgjidhjen e një situatë problemore. Njëkohësisht ai shpjegon tre makina të thjeshta: rrafshin e pjerrët, levën dhe rrotullën. Shpjegoni me pak fjalë situatën problemore dhe nxitini nxënësit të diskutojnë për zgjidhjet e mundshme. Në rast se dikush prej tyre përmend një nga makinat e thjeshta shënojini në dërrasë të zezë. Shpjegoni të tre rastet e zgjidhjes së problemit duke skicuar në mënyrë të thjeshtë figurat përkatëse. Pas çdo skicimi shpjegoni makinën e thjeshtë që përdoret dhe pse ajo na ndihmon në rastin konkret. Kërkojini nxënësve të japin shembuj të tjerë.

Pyetjet në fund të aktivitetit jepni si detyrë shtëpie

Përgjigje të mundshme: 1. Është më e lehtë ta shtysh karrocën në një rrafsh të pjerrët. 2. Krahu i njeriut është levë sepse ai na ndihmon të ngremë, ulim apo zhvendosim objekte të ndryshme me lehtësi. Pika mbështetëse e krahut është bërryli. 3. Rrotulla është makina e thjeshtë që ndihmon ashensorin të lëvizë.

Mësimi 2 STRUKTURAT– Teori

Detyra për t'u realizuar:

- Të lexohet me kujdes mësimi mbi strukturat.
- T'i jepet përgjigje pyetjeve dhe diskutimeve tek aktivitetet e mësimit të ditës.

Materialet: libri i nxënësit faqe 38 – 39.

Objektiva për t'u realizuar:

- Të njihen me konceptin e strukturave.
- Të përshkruajnë materialet që marrin pjesë në ndërtimin e strukturave.
- Të njihen me disa nga makineritë dhe vegla që marrin pjesë në ndërtimin e strukturave.
- Të dallojnë përdorimin e makinerive dhe veglave, si dhe të tregojnë ngjashmëritë midis tyre.

Fjalor: beton.

Përsëritje

Nisur nga detyrat e shtëpisë, si dhe nga objektivat kryesore të përmendura tek libri i mësuesit, bëni një kontroll rreth njohurive të mësuara gjatë orës së kaluar, kontroll që mund të jetë individual apo në grup. Nxitni diskutime në klasë rreth përgjigjeve të detyrave të shtëpisë me anë të shembujve të ndryshëm rreth forcave dhe makinave të thjeshta.

Veprimtari në klasë për kuptimin e mësimit dhe të riprodhimit

Çfarë janë strukturat?

Përmendni disa objekte në klasë apo jashtë saj që mbajnë ngarkesa. Pyetini nxënësit se çfarë kanë të përbashkët ato. Shpjegoni se çdo objekt që mund të mbajë ngarkesa, të lehta apo të rënda është strukturë. Nxitini nxënësit të japin shembuj të tjerë duke i orientuar si drejt ndërtesave, urave, ashtu edhe objekteve si makina, biçikleta, karrigia, çanta, etj.

Ndërtimi i strukturave

Shpjegoni me pak fjalë se materialet që zgjidhen për ndërtimin e strukturave kanë shumë rëndësi. Ne i zgjedhim materialet në bazë të funksionit që duhet të ketë struktura. Shpjegoni shembullin e tavolinës. Ju mund të zgjeroheni duke marrë shembuj të tjerë dhe duke i nxitur nxënësit të japin përgjigje. Aktiviteti 2 dhe 3 bazohet tek materialet e strukturave.

Orientojini nxënësit të flasin për veglat që ne përdorim për ndërtimin e strukturave. Strukturë është si tavolina, ashtu edhe shtëpia, prandaj edhe veglat apo makineritë që na nevojiten mund të jenë të ndryshme. Skicat janë shumë të rëndësishme. Zhvillimi i teknologjisë nuk ka mundur të zbehë rëndësinë e skicimit të objekteve, si një hap fillestar i një dizenjimi, i zhvillimit të një ideje etj. Skicat mund t'i bëjmë shumë shpejt,

në çdo kohë dhe kudo. Mjafton të nxjerrim fletoren tonë të shënimeve dhe të hedhim në letër idenë tonë. Mendimi i parë është gjithmonë i rëndësishëm.

Aktiviteti 1. Materialet e objekteve që përdorim

Materialet e strukturave zgjidhen në përshtatje me funksionin e saj. Diskutoni për karrocën e bebes si strukturë dhe materialet e saj përbërëse që janë: *plastik, metal, gomë, copë, etj.*

Plotësimin e katrorit bosh jepeni si detyrë shtëpie.

Aktiviteti 2. Ndërtesat e larta dhe materialet

Pasi të bëni një përshkrim të shkurtër rreth Kullës Eiffel dhe Monumentit të Uashingtonit përqendrojeni diskutimin tuaj rreth materialeve që janë përdorur. Shkruajini në dërrasë të zeze karakteristikat e të dy strukturave dhe lëroni nxënësit të diskutojnë rreth vetive të hekurit dhe çelikut si material ndërtimi.

Pyetja e dytë të aktivitetit jepeni si detyrë shtëpie.

Aktiviteti 3. Mjetet dhe makineritë

Nxënësit të shikojnë figurat dhe të flasin rreth funksionit që kryejnë makineritë në figurë.

Pyetjen e dytë dhe të tretë mund ta jepni si detyrë shtëpie.

Përgjigje të mundshme: 1. leva, rrotulla dhe pyka. 2. dallimet janë në përdorimin e tyre; ngjashmëria është se ato të gjitha janë apo përdorin makina të thjeshta.

Mësimi 3 PUNË PRAKTIKE

Detyra për t'u realizuar:

- Të lexohet me kujdes mësimi praktik.
- T'i jepet përgjigje pyetjeve dhe diskutimeve tek aktivitetet e mësimit të ditës.
- Të ndiqen hapat për skicimin e një mekanizmi të thjeshtë.

Materialet: libri i nxënësit faqe 40 – 41.

Objektiva për t'u realizuar:

- Të praktikojnë përdorimin e makinave të thjeshta.
- Të njohin mekanizmat dhe të skicojnë një të tillë.

Fjalor: pykë.

Përsëritje

Nisur nga detyrat e shtëpisë, si dhe nga objektivat kryesore të përmendura tek libri i mësuesit, bëni një kontroll rreth njohurive të mësuara gjatë orës së kaluar, kontroll që mund të jetë individual apo në grup. Kontrolloni skicën dhe mund të bëni një përzgjedhje të punimit/eve më të mira.

Ky mësim përmban tre aktivitete që kanë të bëjnë me përdorimin e disa makinave të thjeshta dhe skicimin e një mekanizmi të thjeshtë.

Aktiviteti 1. Veglat e punës si makina të thjeshta

Kujtoni bashkë me nxënësit konceptin e punës nga mësimi i parë. Puna lidhet me zhvendosjen e objekteve.

- Duke përsëritur edhe njëherë disa njohuri mbi makinat e thjeshta realizoni pikën e parë të aktivitetit 1.

Përgjigje: makina llogaritëse dhe koshi i basketbollit nuk janë makina të thjeshta.

- Objektet e paraqitura në pjesën e dytë përbëhen nga dy makina të thjeshta: leva dhe pyka. *Gërshërët shërbejnë për të prerë materiale të ndryshme si letër, copë, fletë metali, etj. Pajisja e perçinimit përdoret për hapjen e vrimave në materiale si: copë, lëkurë etj. Jepni si shembull të përdorimit të kësaj pajisje perçinat e xhinseve. Drejtimi i forcës në të dyja rastet është si ai në figurë.*

Diskutoni bashkë me nxënësit pyetjet në fund të aktivitetit.

Përgjigjet e mundshme: 1. Mjetet shpuese zakonisht ndërtohen me metal (çelik), sepse ai ka vetinë të jetë i fortë, i qëndrueshëm dhe të presë. 2. Forca është shtytëse. 3. Nëse nuk do përdornim tranxhën apo gërshërën, letrën do ta grisnim duke përdorur forcën e tërheqjes; vrimën e perçinës do ta hapnim duke ushtruar forcën e shtytjes.

Aktiviteti 2. Përdorimi praktik i makinave të thjeshta

Ky aktivitet lidhet me gjetjen e makinave të thjeshta që na ndihmojnë të bëjmë një veprim të caktuar.

Ju mund ta jepni plotësimin e tij si detyrë shtëpie.

Përgjigje të mundshme: zbres shkallët – shkallët si rrafsh i pjerrët, krasis pemët – krasitës si pykë dhe levë, hap shishen – hapësja e shishes si levë, pres flokët – gërshërët si pykë dhe levë, çaj arra – çekiçi si levë, ngre pesha – vinçi si rrotull dhe levë, mbush ujë në pus – mekanizmi i mbushjes si rrotull, ha bukë – luga, piruni si pykë dhe levë.

Aktiviteti 3. Skicimi i mekanizmave

Merrni si shembull mekanizmat e përdorur tek rrotat e biçikletës për të kuptuar çfarë është një mekanizëm. Nxitini nxënësit të gjejnë objekte të tjera ku përdoren mekanizmat. Disa shembuj mund të jenë: ora, ashensor, traktori.

Skicimin e mekanizmit mund ta jepni si detyrë shtëpie.

Mësimi 4 USHTRIME

Detyra për t'u realizuar:

- Të zgjidhen ushtrimet dhe realizohet aktiviteti.

Materialet: libri i nxënësit faqe 42.

Objektiva për t'u realizuar:

- Të testojnë njohuritë e kapitullit nëpërmjet zgjidhjes së ushtrimeve.

Përsëritje

Nisur nga detyrat e shtëpisë, si dhe nga objektivat kryesore të përmendura tek libri i mësuesit, bëni një kontroll rreth detyrave të shtëpisë. Për skicën e mekanizmit dhe mund të bëni një përzgjedhje të punimit/eve më të mira.

Ky mësim përbëhet nga një aktivitet e disa ushtrime dhe shërben për të përmbledhur njohuritë e përfituara në këtë kapitull.

Aktivitet 1. Strukturat

Ndërtesat mund të bëhen me materiale të ndryshme. Për përzgjedhjen e tyre ndikon koha kur ato janë ndërtuar, funksioni që do kenë, përmasat e tyre, pamja, etj.

Përgjigjet e mundshme:

1. ura me gurë, ndërtesat e larta me çelik dhe xham, shtëpia me dru.

2. Sot materiali më i mirë për ndërtim është çeliku. Megjithatë përdorimi i tij nuk është gjithmonë zgjidhja më e mirë. Nëse duam të ndërtojmë një shtëpi alpine, druri është zgjidhja e duhur. Kjo sepse druri është izolues mjaft i mirë (të mban ngrohtë në dimër dhe freskët në verë), kushton më pak (druri gjendet aty, nuk ka nevojë të transportohet), ndërtimi i tij është më ekologjik për mjedisin ku do ndërtohet, ndërtimi i tij bëhet me vegla të thjeshta, pa qenë nevoja e përdorimit të makinerive të rënda.

3. Për urën përdoren vegla si daltë, çekiç, mistri, etj.; për ndërtesat e larta makineri të rënda, bashkë me mjete të thjeshta; për shtëpinë vegla si sëpata, gozhda, çekiç, nivelues, etj.

Ushtrime

Duke shfrytëzuar një nga orët e lira, ju mund të bëni një shëtitje në një park lojërash.

Përgjigjet e ushtrimeve mund t'i jepni si detyrë shtëpie

Përgjigjet e mundshme:

- 1. Materialet e lodrave të thjeshta janë në përgjithësi plastike; lojëra si karuseli, mbajtëset e lodrave ndërtohen me metal; trampolina është copë; etj.*
- 2. Pothuajse të gjitha lodrat janë struktura, pasi mbajnë ngarkesa.*

3. Rrëshqitësja, shinat e trenit elektrik janë rrafsh i pjerrët; kolovajza është levë, etj.

Skicimin e objekteve të këndit të lojërave mund ta jepni si detyrë shtëpie



Kapitulli V: Njeriu dhe shoqëria në teknologji

Mësimi 1 NJERIU DHE TEKNOLOGJIA – Teori

Detyra për t'u realizuar:

- Të lexohet me kujdes mësimi mbi teknologjinë.
- T'i jepet përgjigje pyetjeve dhe diskutimeve tek aktivitetet e mësimit të ditës.

Materialet: libri i nxënësit, faqe 44 – 45.

Objektiva për t'u realizuar:

- Të mësojnë arsyet e lindjes së teknologjisë.
- Të përshkruajnë rolin e teknologjisë në jetën tonë.
- Të njihen me disa nga shpikjet që kanë pasuar njëra-tjetrën.
- Të njihen me ndryshimin e objekteve si rezultat i teknologjisë

Prezantimi i kapitullit

Në këtë kapitull nxënësit, do të njihen me ndikimin e teknologjisë në mjedis dhe në jetët tona. Me anë të teknologjisë, ne mund të jemi më të pastër dhe më të shëndetshëm. Procesi i pastrimit të ujit, i krijimit të sapunit, i shpikjes së furçës dhe pastës së dhëmbëve, janë pasojë e drejtpërdrejt e teknologjisë. Edhe shumë nga proceset e përpunimit të ushqimeve që konsumojmë, si qumështi dhe nënproduktet e tij, si buka janë dhuratë e teknologjisë. Në këtë kapitull do të shikojmë me detaje disa nga këto procese.

Veprimtari në klasë për kuptimin e mësimit dhe të riprodhimit

Pse ka lindur teknologjia?

A e njohin nxënësit konceptin e teknologjisë? A e dinë ata përse shërben teknologjia? Pasi t'i keni pyetur nxënësit dhe marrë përgjigjet e tyre, shpjegoni shkurt pse ka lindur teknologjia dhe çfarë është ajo. Teknologjia ka lindur si nevojë e zgjerimit të aftësive të kufizuara të njerëzve për të parë, ecur, prekur, dëgjuar, etj. Duke marrë si shembull objektet me të cilat nxënësit janë në kontakt të vazhdueshëm, tregoni se të gjitha ato janë shpikje teknologjike. Teknologjia përmirëson jetën tonë.

Teknologjia përmirëson jetët tona.

Në sajë të zhvillimit të teknologjisë, jeta jonë është bërë më e lehtë. Ndajini nxënësit në tre grupe, secili grup të zgjedhë një objekt që ata mendojnë që ka ndikuar mjaft në lehtësimin e vprimeve. Lëreni diskutimin të rrjedhë lirshëm.

Aktivitet 1. Si ndikon teknologjia në jetën tonë.

Me anë të këtij aktiviteti, nxënësit do të arrijnë të bëjnë dukshëm dallimin midis një bote me dhe pa teknologji.

Nxënësit mund të plotësojnë në libër kërkesat. Ju mund ta jepni këtë si detyrë shtëpie.

Aktiviteti 2. Zhvillimi i objekteve

Sugjerohet që nxënësit të hapin librin në faqen 45 dhe të shohin tre modele të biçikletës sipas viteve të prodhimit të tyre. Shpjegoni se biçikleta është një ndër mjetet që teknologjia ka përmirësuar në sajë të nevojës dhe kërkesës së njerëzve për ta ndryshuar atë.

Përgjigje të mundshme: 1. Biçikleta e parë është ndërtuar në vitin 1817, periudhë në të cilën druri ishte materiali kryesor i ndërtimit të objekteve. 2. Biçikleta e dytë është më e fortë dhe më e lehtë se e para, si rrjedhim ajo është më rezistente dhe ecën me një shpejtësi më të madhe; është më e rehatshme sepse ka shalë me një material më të butë se druri. Biçikleta e tretë, me trup alumini është akoma më e lehtë se biçikleta me trup çeliku, sepse dimë që alumini është më i lehtë se çeliku. Është më e shpejtë dhe më e rehatshme se biçikleta e vitit 1913. 3. Po të bazohemi te kërkesat tona, biçikleta e tretë është më e mira, por biçikleta e parë është më e mirë për mjedisin.

Aktiviteti 3. Çdo shpikje pason një shpikje të re.

Njeriu karakterizohet nga një natyrë që nuk kënaqet me pak dhe që është në kërkim të vazhdueshëm për të përmirësuar dhe lehtësuar veprimet e tij. Ai shpik një objekt i cili më vonë shërben për lindjen e një objekti të ri me një funksion të caktuar.

Sipas shembullit, nxënësit të plotësojnë ushtrimin në fund të aktivitetit.

Nxënësit mund të plotësojnë në libër shembujt. Ju mund ta jepni këtë si detyrë shtëpie.

Mësimi 2 TEKNOLOGJIA DHE MJEDISI - Teori

Detyra për t'u realizuar:

- Të lexohet me kujdes mësimi mbi ndikimin e teknologjisë në mjedis.
- T'i jepet përgjigje pyetjeve dhe diskutimeve tek aktivitetet e mësimit të ditës.

Materialet: libri i nxënësit, faqe 46 - 47.

Objektiva për t'u realizuar:

- Të njihen me ndikimin negativ që ka teknologjia mbi mjedis.
- Të mësojnë për ndikimin e veprimeve të tyre në mjedis.
- Të njihen me disa mënyrat e mbrojtjes së mjedisit.
- Të krahasojnë ndikimin e biçikletës dhe makinës në mjedis.

Fjalor: ndotje

Përsëritje

Nisur nga detyrat e shtëpisë, si dhe nga objektivat kryesore të përmendura tek libri i mësuesit, bëni një kontroll rreth njohurive të mësuara gjatë orës së kaluar, kontroll që mund të jetë individual apo në grup. Nxitni diskutime në klasë rreth përgjigjeve të detyrave të shtëpisë.

Veprimtari në klasë për kuptimin e mësimit dhe të riprodhimit

Ndotja e mjedisit

Citoni disa efekte pozitive që sjell zhvillimi i teknologjisë në mjedisin ku jetojmë. Pyetini nxënësit nëse ka anë negative të zhvillimit të teknologjisë. Shkruani në dërrasë, përgjigjet e nxënësve. Shpjegoni me pak fjalë çfarë janë mbetjet dhe mbeturinat.

Mbrojtja e mjedisit

Pyetini nxënësit nëse para se të kryejnë një veprim, a mendojnë se po ndikojnë në mjedis. Shënoni në dërrasë të zezë veprimet e tyre duke i ndarë në negative dhe pozitive. Shpjegoni se çdo veprim i tyre, në dukje i parëndësishëm ka efektin e tij në mjedis. Një mjedis i pastër është i rëndësishëm jo vetëm për ata, por edhe për motrat dhe vëllezërit më të vegjël, për të gjithë ne.

Aktiviteti 1. Veprimet e mia dhe mjedisi

Duke parë figurat e mëposhtme, diskutoni me nxënësit për pasojat e veprimeve të dhëna në mjedis.

Të dyja figurat paraqesin veprime me efekt pozitiv mbi mjedisin.

Plotësimin e katrorit mund ta jepni si detyrë shtëpie.

Përgjigje të mundshme: Hedh mbeturinat në kosh; nuk lë televizorin ndezur, mbaj pastër ambientin në shkollë, etj.

Aktiviteti 2. Makina, biçikleta dhe mjedisi

Pyetini nxënësit, sa prej tyre vijnë në shkollë me biçikleta dhe sa me makina. Nxënësit të shikojnë figurat dhe të diskutojnë rreth tyre. Duke u dhënë përgjigje pyetjeve të aktivitetit, lërin nxënësit të nxjerrin përfundimet e tyre, se cili mjet transporti është më i mirë për mjedisin.

Aktiviteti 3. Makina, biçikleta dhe shëndeti

Në aktivitetin 2, nxorët disa rezultate për efektin që ka përdorimi i biçikletës dhe makinës në mjedis. Pyesni nxënësit a kanë këto mjete ndikim në shëndetin tonë? Si ndikojnë ato?

Për përgjigjet e tyre, nxënësit le të bazohen edhe në shprehjet dhe figurat e dhëna.

Mësimi 3 UJI DHE DOBIA E TIJ - Teori

Detyra për t'u realizuar:

- Të zgjidhet situata problemore në aktivitetin 1 tek libri i nxënësit.
- T'i jepet përgjigje pyetjeve dhe diskutimeve tek aktivitetet e mësimit të ditës.

Materialet: libri i nxënësit faqe 48 – 49.

Objektiva për t'u realizuar:

- Të riprodhojnë udhëtimin e ujit;
- Të skicojnë në letër rrugën që përshkon uji për të ardhur në shtëpi.
- Të flasin rreth dobisë së ujit.
- Të listojnë proceset e përpunimit të ujit.

Fjalor: pastrimi, dezinfektimi.

Përsëritje

Nisur nga detyrat e shtëpisë, si dhe nga objektivat kryesore të përmendura tek libri i mësuesit, bëni një kontroll rreth njohurive të mësuara gjatë orës së kaluar, kontroll që mund të jetë individual apo në grup. Nxitni diskutime në klasë rreth përgjigjeve të detyrave të shtëpisë.

Veprimtari në klasë për kuptimin e mësimit dhe të riprodhimit

Rëndësia e ujit

Shkruani në dërrasë të zeze apo u shpërndani të fotokopjuar nxënësve pjesën e mëposhtme të shkëputur nga Karta Evropiane e Ujit miratuar nga Këshilli i Evropës në 1986:

1. *Nuk ka jetë pa ujë. Ai është një pasuri e pazëvendësueshme për të gjithë veprimtarinë njerëzore.*
2. *Burimet e ujërave të ëmbla nuk janë të pashtershme. Është jetike t'i ruajmë, t'i kontrollojmë, madje dhe t'i shtojmë.*
3. *Të ndryshosh cilësinë e ujit do të thotë të dëmtosh njeriun dhe të gjithë gjallesat e tjera, jeta e të cilave varet nga uji.*

Diskutoni bashkërisht në klasë rreth këtyre tre pikave. Karta flet për rëndësinë e ujit. Ju mund ta zgjeroni duke folur për përfshirjen e gjerë që ka uji në veprimet tona të përditshme. Për këtë mund të bazoheni tek shembujt e dhënë tek libri i nxënësit.

Uji në shtëpitë tona

Me anë të një skeme të thjeshtë duhet të flisni për rrugëtimin që merr uji për të ardhur në shtëpitë tona. Kujdes! Atyre u duhet folur jo vetëm për rrugëtimin, por edhe për proceset në të cilat kalon uji për të ardhur në atë formë që të mos dëmtojë shëndetin tonë.

Nxënësit duhet të dinë se uji trajtohet jo vetëm para se të vijë në shtëpitë tona, por edhe pasi del nga ato. Shpjegoni me fjalë të thjeshta trajtimin e ujërave të zeza dhe domosdoshmërinë e këtij procesi.

Aktiviteti 1. Çdo pikë uji është e rëndësishme.

Klasën e ndani në dy grupe. Secili grup do të zgjedhë një përfaqësues për të dalë dhe për të zgjidhur në dërrasë të zeze pikën e parë të aktivitetit. Dërrasën e ndani në dy pjesë. I ftoni nxënësit që ta zgjidhin në formën e një probleme. Pikën e parë e merr grupi që e ka zgjidhur saktë.

a. Përgjigja:

$$15 \times 2 = 30 \text{ litra ujë harxhojnë në ditë}$$

$$30 \times 365 = 10950 \text{ litra ujë në vit}$$

$$10950 : 1000 = 10,95 \text{ vite jetë}$$

Një njeri me këtë ujë do të jetonte rreth 11 vite jetë.

b. Përgjigjet e mundshme:

larja e duarve, fytyrës, dhëmbëve në mëngjes – nuk e lëmë rubinetin hapur; bërja dush në vend të banjës – e kursejmë ujin gjatë dushit; shpëlarja e banjës – e përdorim ujin me shumë ekonomi; larja e enëve – nuk e lëmë rubinetin hapur; larja e rrobave – lavatriçe ekonomike, lajmë me kapacitetin e plotë të lavatriçes; larja e mjedisit rrethues – 1 herë në javë; ujitja e luleve – jo me markuç.

Aktiviteti 2. Udhëtimi i ujit

Sugjerohet që nxënësit të hapin librin në faqen 49 dhe të shikojnë figurën. Diskutoni rreth saj.

Këtë aktivitet mund ta jepni si detyrë shtëpie.

Përgjigjet e mundshme: 1. Radhitja e emrave që mungojnë është si më poshtë: avullimi, rënia e shiut, depërtimi në tokë, përdorimi, trajtimi i ujërave, derdhja në det, nga e majta në të djathtë.

2. Uji është mjaft i domosdoshëm për jetën e gjallesave në Planetin Tokë; për embrionin në barkun e nënës; për kafshët shtëpiake për të dhënë prodhim; në industri; për makinat.

Mësimi 4 SAPUNI – Teori

Detyra për t'u realizuar:

- Të lexohet mësimi mbi sapunin dhe përfitim të tij.
- Të realizohet eksperimenti.

Materialet: libri i nxënësit, faqe 50, pastë dhëmbësh, gotë me ujë, 2 lugë vaj gatimi, pastrues enësh i lëngshëm.

Objektiva për t'u realizuar:

- Të kuptojnë rëndësinë e sapunit në higjienën tonë.
- Të njihen me disa nga mënyrat e përfimit të sapunit.
- Të kuptojnë pse pastron sapuni.

Fjalor: sodë kaustike.

Përsëritje

Nisur nga detyrat e shtëpisë, si dhe nga objektivat kryesore të përmendura tek libri i mësuesit, bëni një kontroll rreth njohurive të mësuar gjatë orës së kaluar, kontroll që mund të jetë individual apo në grup.

Veprimtari në klasë për kuptimin e mësimit dhe të riprodhimit

Përdorimi dhe përfitimi i sapunit

Ndani klasën në dy grupe dhe secili grup të shkruajë mënyra të përdorimit të sapunit. Krahasoni dhe diskutoni rezultatet. Nxirrni konkluzionin se sapuni është i rëndësishëm për higjienën.

Pyetini nxënësit se si pastroheshin njerëzit në kohërat e hershme? A është sapuni një shpikje e re? Më pas shpjegoni se higjiena ka qenë gjithmonë e rëndësishme dhe njerëzit kanë gjetur mënyra për pastrim. Tregoni duke krahasuar përfitimin e sapunit në të kaluarën dhe të tashmen.

Eksperimenti

Diskutoni me nxënësit a i lajnë ata ndonjëherë duart pa sapun? Në çfarë shtate? Si mendojnë ata, a lahen mirë duart pa përdorur sapunin? Shpjegoni se sapuni ka vetinë të bashkojë ujën me yndyrën duke larguar në këtë mënyrë yndyrën nga duart apo enët.

Eksperimentin realizojeni në klasë ose jepeni si detyrë shtëpie.

Mësimi 5 FURÇA DHE PASTA E DHËMBËVE – Teori

Detyra për t'u realizuar:

- Të lexohet mësimi mbi furçën dhe pastën e dhëmbëve.
- Të realizohet eksperimenti.

Materialet: libri i nxënësit, faqe 51, enë për përzierje, 4 lugë kafeje me sodë buke, 1 lugë kafeje gjelle me kripë, 1 lugë kafeje vaj mente, vanilje, ujë, tas, lugë, furçë dhëmbësh

Objektiva për t'u realizuar:

- Të kuptojnë rëndësinë e furçës dhe pastës në higjienën tonë.
- Të njihen me disa nga mënyrat e përfitimit të tyre.
- Të bëjnë një pastë dhëmbësh në kushtet e shtëpisë.

Përsëritje

Nisur nga objektivat kryesore të përmendura tek libri i mësuesit, bëni një kontroll rreth njohurive të mësuara gjatë orës së kaluar, kontroll që mund të jetë individual apo në grup. Pyesni nxënësit rreth eksperimentit të kryer dhe konkluzionet diskutojini ato bashkërisht.

Veprimtari në klasë për kuptimin e mësimit dhe të riprodhimit

Pasta dhe furça e dhëmbëve

Shpjegoni nxënësve se si do t'i pastronin dhëmbët nëse do të jetonin në Egjiptin e Lashtë. Diskutimin e tyre orientojeni rreth mjeteve dhe njohurisë së njerëzve në atë

kohë për higjienën e gojës. Më pas shpjegoni, se njerëzit pavarësisht epokës ku kanë jetuar, gjithmonë janë përpjekur t'i lajnë dhëmbët, pasi ata janë tepër të rëndësishëm për higjienën dhe shëndetin. Shkruani në dërrasë disa etapa të zhvillimit të fuqës dhe pastës së dhëmbëve.

Eksperimenti

Jepini njërit nxënës pastën e dhëmbëve dhe i kërkonti të lexojë përbërësit. Sa nga ato njihet ai? A është e rëndësishme të njohim përbërësit e një produkti para se ta fusim atë në gojë tonë? Shpjegoni se ata mund të krijojnë një pastë dhëmbësh duke përdorur vetëm sodë buke.

Eksperimentin realizojeni në klasë ose jepeni si detyrë shtëpie.

Mësimi 6 PUNË PRAKTIKE

Detyra për t'u realizuar:

- Të lexohet me kujdes mësimi praktik mbi higjienën.
- Të zbatohen aktivitetet dhe të realizohet poster i pastërtisë.
- Të bëjnë një vizatim me temë mbi pastërtinë.

Materialet: libri i nxënësit, faqe 52 – 53.

Objektiva për t'u realizuar:

- Të njihin disa nga mjetet që i ndihmon ata në larjen e duarve.
- Të diskutojnë për radhën e veprimeve të larjes së duarve.
- Të njihen me disa nga përdorimet e tjera të pastës së dhëmbëve si pastrues.
- Të përcjellin vetë një mesazh për pastërtinë.

Përsëritje

Nisur nga objektivat kryesore të përmendura tek libri i mësuesit, bëni një kontroll rreth njohurive të mësuara gjatë orës së kaluar, kontroll që mund të jetë individual apo në grup. Pyesni nxënësit rreth eksperimentit të kryer dhe konkluzionet diskutojini ato bashkërisht. Ky mësim përmban tre aktivitete që lidhen me pastrimin e duarve, përdorimin e pastës së dhëmbëve si pastrues dhe mesazhin e nxënësve për pastërtinë.

Aktiviteti 1. Mikrobet janë kudo, lani duart!

Niseni mësimin duke shkruar në dërrasë të zezë: Mikrobet janë kudo, lani duart. Më pas pyesni nxënësit se a e dinë ata në çfarë situatash duhet t'i lajnë duart? Përgjigjet e tyre shkruajini në dërrasë të zezë.

Përgjigje të mundshme: Para dhe pasi shkojmë në banjë, para dhe pasi kujdesemi për dikë që është sëmurë, pasi shfryjmë hundët, kollitemi apo teshtijmë, pasi përkëdhelim një kafshë, pasi mjekojmë një plagë, etj.

Sugjerohet që nxënësit të hapin librin në faqen 52 dhe të shohin figura në aktivitetin 1. Pyetini ata se a e dinë çfarë tregojnë ato dhe bashkërisht gjeni radhën e figurave. Në fund të aktivitetit nxënësit t'u përgjigjen pyetjeve të tjera.

Përgjigje të mundshme: 1. Radha e veprimeve është:

1 – 5 – 6 – 4 – 3 – 2. Renditja bëhet duke filluar lart nga e majta në të djathtë. 2. sapunin apo larës të lëngshëm, çezmën, lavamanin, peshqirin.

Aktiviteti 2. Pastroni dhe aromatizoni me pastë dhëmbësh.

Çfarë bëjmë ne me pastë dhëmbësh? Shkruajeni këtë pyetje në dërrasë të zezë dhe prisni përgjigje nga nxënësit. Pavarësisht se përgjigja e tyre kryesore, do të jetë larja e dhëmbëve, ndoshta disa prej tyre mund të japin përgjigje që lidhen me përdorimin e pastës së dhëmbëve si pastrues dhe aromatizues. Shpjegoni më tej pasta e dhëmbëve midis shumë përbërësve, ka edhe sapun dhe aromatizues.

Plotësimin me shembuj të tjerë jepeni si detyrë shtëpie

Përgjigje të mundshme: Pastroni: hekurin e rrobave, bizhuteritë, shenjat në material lëkure, mobiliet, tastet e pianos. Aromatizoni: shishet plastike dhe kutitë, makinën (vendosni pak pastë dhëmbësh në një letër kuzhine, paloseni dhe vendoseni poshtë sediljes së makinës. Kur të nxehet nga dielli, pasta do të lëshojë aromën e mentes. Zëvendësojeni kur nuk lëshon më aromë.)

Aktiviteti 3. Mesazhi juaj për pastërtinë

Hapni librin e nxënësit në faqen 53 dhe lëroni nxënësve pak kohë për të parë figurën në aktivitetin 3. Më pas pyetini se a u ka pëlqyer ilustrimi. Çfarë mesazhi përcjell ajo? Diskutimin lëroni të rrjedh lirshëm.

Krijimin e mesazhit jepeni si detyrë shtëpie.

Ju mund të organizoni një konkurs midis nxënësve të klasave të pesta rreth këtij aktiviteti. Jepini nxënësve rreth dy javë kohë dhe në një nga orët e lira mund të shpallni fituesit për mesazhin më të bukur, vizatimin më të mirë, etj.

Mësimi 7 BUKA DHE PRODHIMI I SAJ – Teori

Detyra për t'u realizuar:

- Të lexohet me kujdes mësimi mbi bukën dhe prodhimin e saj.
- T'i jepet përgjigje pyetjeve dhe diskutimeve tek aktivitetet e mësimin të ditës.
- Të realizohet eksperimenti.

Materialet: libri i nxënësit, faqe 54 – 55.

Objektiva për t'u realizuar:

- Të njiheni me rëndësinë e bukës si ndër ushqimet më të përdorshëm dhe të rëndësishëm.
- Të njihen me origjinën e bukës.
- Të përshkruani rrugën nëpër të cilën kalon buka.
- Të praktikoheni duke bërë bukë në kushtet e shtëpisë.

Ju mund të shfrytëzoni një nga orët e lira për të bërë një vizitë në një nga punishtet e prodhimit të bukës, për të parë nga afër proceset e përfundimit të bukës, si dhe mjetet apo pajisjet që përdoren.

Përsëritje

Nisur nga detyrat e shtëpisë, si dhe nga objektivat kryesore të përmendura tek libri i mësuësit, bëni një kontroll rreth njohurive të mësuara gjatë orës së kaluar, kontroll që mund të jetë individual apo në grup.

Veprimtari në klasë për kuptimin e mësimin dhe të riprodhimit

Çfarë është buka?

Shkruani në dërrasë të zezë fjalët: **bukë, pica, kulaç, byrekë**. Pyetini nxënësit se çfarë kanë të përbashkët produktet e mësipërme. Sigurohuni që nxënësit të kuptojnë së ngjashmëria kryesore e tyre është se të gjitha ato janë ushqime. Pasi të keni dëgjuar përgjigjet, ju mund të shënoni ato më interesantet në tabelë, shpjegoni se të gjitha këto ushqime bëhen me miell, i cili prodhohet nga drithërat. Më pas shpjegoni me pak fjalë se çfarë janë drithërat dhe disa nga llojet e tyre.

Si prodhohet buka?

Këtë teori zhvilloheni së bashku me aktivitetin 1. Shpjegoni fillimisht se teknologjia ka përmirësuar edhe proceset e përpunimit të bukës. Kështu: korrja dikur bëhej vetëm me drapër apo kosë, tani me autokombajna; bluarja bëhej në mulli guri, tani në fabrika të posaçme; pjekja bëhej me soba me dru, tani më furra speciale të pjekjes.

Ekskursioni do i ndihmojë më mirë nxënësit të njohin pajisjet që përdoren sot për prodhimin e bukës.

Aktiviteti 1. Nga gruri tek buka

Nxënësit të shikojnë figurat dhe të diskutojnë rreth tyre. Të përshkruajnë rrugën që nga mbjellja e grurit deri te ardhja e bukës në tavolinat tona.

Ju mund të ngrini një nxënës në klasë për ta plotësuar dhe të tjerët të plotësojnë në libër.

Për pyetjen në fund të aktivitetit diskutoni me nxënësit për llojet e ndryshme të bukëve (p.sh. dyqani ofron bukë të posaçme për diabetikët).

Aktiviteti 2. Dita e bukëpjekësit tim

Pyetini nxënësit nëse e blejnë ata bukën për familjen e tyre. Me siguri që shumë prej tyre, kanë shkuar vetëm ose të shoqëruar me prindërit në dyqanin e bukës. Le të tregojnë për llojet e ndryshme të bukës, si nga madhësia, forma, ngjyra, shija dhe le të diskutojnë. A kanë patur ndonjëherë pakënaqësi ndaj bukës që kanë blerë? Si kanë vepruar në këtë rast.

Vini në dukje se sot në dyqanet e bukës është shtuar një shërbim tjetër, ai i prerjes së bukës në feta. Pajisja e parë mekanike që pret bukën në feta, është shpikur nga Otto Frederick Rohwedder, në vitin 1928. Kjo shpikje u konsiderua aq e rëndësishme, sa për një inovacion të ri njerëzit përdornin shprehjen “Kjo është shpikja më e madhe që nga prerësja e bukës”.

Ekspëriment

Me ndihmën e nënave dhe gjysheve, krijoni dyqanin tuaj të bukës në shtëpi. Ndiqni me kujdes hapat e dhënë. Sipas dëshirës, nxënësit mund të sjellin në klasë një fetë apo copë të bukës që kanë prodhuar vetë dhe ta krahasojnë me atë të shokëve të klasës.

Ekspërimentin për prodhimin e bukës jepeni si detyrë shtëpie.

Mësimi 8 QUMËSHTI DHE NËNPRODUKTET E TIJ – Teori

Detyra për t’u realizuar:

- Të lexohet me kujdes mësimi mbi qumështin, nënproduktet dhe procesin e përpunimit të tij.
- T’i jepet përgjigje pyetjeve dhe diskutimeve tek aktivitetet e mësimin të ditës.
- Të realizohen ekspërimentet.

Materialet: libri i nxënësit, faqe 56 – 57.

Objektiva për t’u realizuar:

- Të njihen me rëndësinë e qumështit.
- Të njihen me nënproduktet e tij.
- Të njihen me proceset e përpunimit të qumështit dhe me rëndësinë e tyre.
- Të mësojnë të prodhojnë nënprodukte të qumështit në kushtet e shtëpisë.

Përsëritje

Nisur nga detyrat e shtëpisë, si dhe nga objektivat kryesore të përmendura tek libri i mësuesit, bëni një kontroll rreth njohurive të mësuara gjatë orës së kaluar, kontroll që mund të jetë individual apo në grup. Kontrolloni nxënësit sa e kanë përvetësuar procesin e prodhimit të bukës në shtëpi. Pyesni nxënësit rreth eksperimentit të kryer dhe konkluzionet diskutojini ato bashkërisht.

Veprimtari në klasë për kuptimin e mësimit dhe të riprodhimit

Rëndësia dhe nënproduktet e qumështit.

Pyesni nxënësit çfarë hanë për mëngjes. Me siguri shumica prej tyre do të thotë qumësht të shoqëruar me reçel apo çokokrem. Shkruani në dërrasë përgjigjet dhe qumështi është produkti më i përmendur. Niseni nga ky aktivitet për të shpjeguar se pse qumështi është kaq i rëndësishëm dhe çfarë vlerash ushqyese përmban. Pas kësaj, pyesni nxënësit nëse e dinë nga bëhet gjalpi, djathi, gjiza, ajka, kosi. Duke u bazuar në përgjigjet e tyre, u tregoni nxënësve që të gjitha këto janë nënprodukte të qumështit, pasi qumështi është elementi kryesor i prodhimit të tyre. Pyetini nxënësit çfarë ushqimi mund të gatuajmë duke patur qumështin si ingredient.

Përpunimi i qumështit

Qumështi është një produkt që vjen në tavolinat tona, pas një sërë procesesh. Përcaktoni dy nxënës, njëri të përshkruajë mënyrën se si e konsumojnë qumështin njerëzit që jetojnë në fshat dhe ata në qytet. Gjatë përgjigjeve të tyre, ju do t'i ndihmoni ata duke u treguar për proceset nëpër të cilin kalon qumështi, që nga mjelja e deri te rëndësia e pasterizimit dhe homogjenizimit.

Aktiviteti 1. Rrugëtimi i qumështit

Nxënësit të shikojnë figurat dhe të diskutojnë rreth tyre. Ju mund të ngrini një nxënës në klasë për ta plotësuar dhe të tjerët të plotësojnë në libër.

Përgjigje të mundshme: 1. Pasterizimi shërben për zhdukjen e baktereve të ndryshme që përmban qumështi. Pra, nëse ky proces nuk do të realizoj, njerëzit që do të konsumonin këtë qumësht do të sëmureshin. 2. Njerëzit që jetojnë në fshat, pas mjeljes së qumështit, e ziejnë atë në një temperaturë të lartë, deri sa të vlojë. Temperatura e lartë vret mikrobet që përmban qumështi.

Eksperiment Prodhimi i gjalpit në kushtet e shtëpisë.

Duke ndjekur hapat e dhënë, nxënësit le të përgatisin gjalpë në shtëpitë e tyre. Nxënësit të flasini për eksperiencat e tyre.

Që të përgatisim gjalpë duhet të kemi ajkë, e cila përmban shumë yndyrë. Nxënësit e kanë mësuar konceptin e homogjenizimit. Me qumësht të homogjenizuar 1%, nuk e përgatisim dot gjalpin, pasi ky qumësht nuk përmban yndyrë mjaftueshëm.

Eksperimentin për prodhimin e gjalpit jepeni si detyrë shtëpie..

Eksperiment Prodhimi i djathit të butë në shtëpi.

Duke ndjekur hapat e dhënë dhe me materialet e përmendura, nxënësit le të përgatisin pak djathë të butë në shtëpitë e tyre dhe të flasin për eksperiencat e tyre. Nxënësit le të krahasojnë shijen e djathit të tyre me atë të blerë dhe le të diskutojnë.

Eksperimentin për prodhimin e djathit jepeni si detyrë shtëpie.

Mësimi 9 PUNË PRAKTIKE

Detyra për t'u realizuar:

- Të lexohet me kujdes mësimi praktik mbi prejardhjen dhe klasifikimin e ushqimeve.
- Të ndiqen hapat për realizimin e tyre.

Materialet: libri i nxënësit faqe 58 – 59.

Objektiva për t'u realizuar:

- Të vënë në praktik njohuritë e tyre për prejardhjen dhe klasifikimin e ushqimeve.

Përsëritje

Nisur nga objektivat kryesore të përmendura tek libri i mësuesit, bëni një kontroll rreth njohurive të mësuara gjatë orës së kaluar, kontroll që mund të jetë individual apo në grup. Pyesni nxënësit rreth eksperimenteve të kryera dhe konkluzionet diskutojini ato bashkarisht.

Ky mësim përmban dy aktivitete që kanë të bëjnë me prejardhjen dhe klasifikimin e produkteve ushqimore.

Aktiviteti 1. Prejardhja e ushqimeve

Shkruani në dërrasë të zezë fjalët: *lëng molle, proshutë, vezë e zier*. Pyetini nxënësit se nga vijnë ushqimet e shënuara në dërrasë.

Pastaj nxënësit, të hapin librin dhe të plotësojnë figurën sipas shembullit të dhënë. Pasi të kenë mbaruar plotësimin, shpjegoj origjinën bimore apo shtazore të ushqimeve.

Përgjigje të mundshme: 1. Kosi, djathi dhe gjalpi janë produkte me prejardhje shtazore pasi janë nënprodukte të qumështit. 2. Përbërësi kryesor i kekut është mielli dhe jo gjalpi. Prandaj, keku është me prejardhje bimore, pasi edhe mielli ka prejardhjen nga bimët.

Aktiviteti 2. Klasifikimi i ushqimeve

Sugjerohet që nxënësit të hapin librin në faqen 59 dhe bashkë diskutoni mbi ndarjen e ushqimeve. Drejtoni pyetje si: çfarë hanë ata më shumë dhe çfarë më pak; a e kuptojnë ndarjen e sasive në pjatë, etj. Pasi të dëgjoni përgjigjet shpjegoni ekuilibrin ushqimor dhe rëndësinë e tij për shëndetin. Ushqimet që nxënësit duhet të hanë gjatë ditës duhet të jenë në proporcion të njëjtë me sasitë në pjatë.

Diskutoni bashkërisht edhe për pyetjet në fund të aktivitetit.

Mësimi 10 USHTRIME

Detyra për t'u realizuar:

- Të zgjidhen ushtrimet dhe realizohet aktiviteti.

Materialet: libri i nxënësit faqe 60.

Objektiva për t'u realizuar:

- Të njohin dëmet që shkakton duhani dhe pirja e tij në shëndet dhe mjedis.
- Të testojnë njohuritë e kapitullit nëpërmjet zgjidhjes së ushtrimeve.

Ky mësim përbëhet nga një aktivitet dhe disa ushtrime. Shërben për të përmbledhur njohuritë e përfituara në këtë kapitull.

Aktivitet

Sugjerohet që nxënësit të shikojnë figurat dhe të diskutojnë mbi efektet e duhanit në mjedis dhe shëndet.

Duhani dhe shëndeti.

Përgjigje të mundshme: 2. Jo, nuk mjafton për të mbrojtur shëndetin. Duhani dëmton mushkëritë dhe kjo nuk mund të shërohet me pastë dhëmbësh apo sapun. 3. Me prejardhje bimore. 4. Nuk klasifikohet si ushqim.

Duhani dhe mjedisi.

Përgjigje të mundshme: 2. Duhani është edhe mbetje (tymi), edhe mbeturinë (bishtat e cigareve). 3. Po, e ndot. Shpesh bishtat e cigareve përfundojnë në tokë dhe pastaj në ujë duke e ndotur atë. Por edhe bima e duhanit e ndot ujin. 4. Prodhimi i duhanit kërkon kimikate të ndryshme të cilat e ndotin tokën ku mbillet duhani dhe mbeturinat e tyre ndotin edhe ujin apo ajrin. Prerja e një peme, ndihmon në prodhimin e rreth 300 cigareve (letra mbështjellëse).


B. Ushtrime

1. E vërtetë apo e gabuar.

1V, 2V, 3G, 4G, 5V, 6G,
7G, 8V, 9G, 10G, 11V.

Në lidhje me pikën 4, diskutoni.

Përgjigje e mundshme: energjia çlirohet nga karbohidratet, proteinat etj, dhe uji nuk përmban asnjë nga këto. Por, ai luan rol të rëndësishëm në vënien në punë të energjisë. Asnjë nga veprimet tona të përditshme nuk kryhet pa ujin, pasi vetë trupi ynë përmban rreth 70% ujë.



Librat e mësuësit dhe planet mësimore për të gjithë titujt që ne disponojmë, mund t'i gjëni dhe t'i shkarkoni pa pagesë nga faqja e internetit **www.mediaprint.al**

Për më shumë informacion mund të na shkruani në adresën e emailit: **botime@mediaprint.al** ose të na kontaktoni pranë redaksisë në numrin e telefonit: **04 2256158**.

www.mediaprint.al

Çmimi 200 lekë

ISBN: 978-99956-93-72-5



9 789995 1693725

SHTËPIA BOTUESE
mediaprint